



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE DHE VLERËSUES NË MINISTRINË E**  
**SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR,**  
**BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË ME FOKUS PLANIN KOMBËTAR PËR**  
**DEINSTITUCIONALIZIMIN E FËMIJËVE 2020-2022”**

**Tiranë, maj 2022**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
I. 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit .....	3
I. 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve .....	3
I. 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Vlerësimi i auditimit.....	9
II. HYRJE .....	12
II. 1. Objektivi i auditimit.....	12
II. 2. Qëllimi i auditimit .....	12
II. 3. Identifikimi i çështjes.....	13
II. 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	13
II. 5. Përgjegjësitë e audituesve.....	13
II. 6. Kriteret e vlerësimit .....	13
II. 7. Standardet e auditimit .....	14
II. 8. Metodatat e auditimit .....	14
II. 9. Dokumentimi i auditimit .....	14
III. PËRSHKRIMIAUDITIMIT.....	15
III. 1 Mbi plotësinë e kuadrit rregullator në funksion të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit.....	15
III. 2 Mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 - 2022 .....	22
III. 3 Mbi auditimin e shpenzimeve të kryera në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022 .....	41
VI. GJETJE DHE REKOMANDIME .....	57



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

**I. 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Raporti i auditimit të përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar për De-institucionalizimin e fëmijëve 2020 ó 2022ö është ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Shërbimin Social Shtetëror, në Bashkinë Korçë dhe në Bashkinë Vlorë për periudhën 01.09.2020 - 30.11.2021.

Projekti i këtij auditimi është miratuar nga Kryetari i KLSH me Programin nr. 1267/1 prot., datë 22.11.2021, nga data 18.11.2021 deri më datë 14.02.2022 - òAuditim i përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar për De ó institucionalizimin e fëmijëve 2020 ó 2022ö - në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Shërbimin Social Shtetëror, në Bashkinë Korçë dhe Vlorë për periudhën 01.09.2020 - 30.11.2021. Ky auditim i cili u orientua në tre drejtime:

- plotësinë e kuadrit rregullator në funksion të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit;
- zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022;
- auditimin e shpenzimeve të kryera në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022.

Raport përfundimtar për këtë auditim është i strukturuar në katër kapituj. Në kapitullin e parë jepet përmbledhja ekzekutive, në kapitullin e dytë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe vlerësimi, bazuar në rezultatet e auditimit. Në kapitullin e tretë është përshkrimi i auditimit, me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejtimeve. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kapitullin e katërt.

**I. 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale (në vijim MSHMS) nuk është konkluduar rivendosja në afat e Planit Kombëtar për Deinstitutionalizimin dhe efektet e tij, duke krijuar konfuzion si në zbatimin e afateve, po ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë plan. Janë diskutuar afatet e reja të zbatimit të këtij plani dhe janë përfshirë në Progres raportin e vitit 2021 të miratuar nga Komiteti në janar të vitit 2022, por këto ende nuk janë reflektuar në përditësimin e tij.	E Lartë	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 1) faqe (9) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të integruar Planin e Veprimit me afatet e rivendosura me Progres raportin e vitit 2021, miratuar në janar të vitit 2022, me qëllim zbatimin e Planit të Veprimit në kohë dhe me cilësi.
2.	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS nuk është dokumentuar konsultimi me	E Lartë	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 1) faqe (9)</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të



**KONTROLLI I LARTË I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËNDETËSOR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	ministrinë e linjës, agjencitë zbatuese dhe grupet e interesit, për draftin e ndryshimeve ligjore të propozuara, në kundërshtim me objektivin nr. 1.1/c të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020 dhe miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Gjithashtu nga e njëjta strukturë në MSHMS nuk është realizuar hartimi i akteve nënligjore/moduleve dhe udhëzuesve sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë, në kundërshtim me objektivin nr. 1.1/d të Planit cituar më lart, si dhe nuk është realizuar hartimi dhe kostimi i paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki, në kundërshtim me objektivin nr. 1.2/a.		<i>të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)</i>	Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të realizuar në afat dhe me cilësinë e kërkuar të gjithë objektivat e përcaktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e PKD.
3.	Nga dokumentacioni që administrohet në MSHMS për projekt propozimin e Bashkisë Vlorë rezultojnë se, për dorëzimin e projekt propozimit, Kryetari i Bashkisë Vlorë, i është drejtuar MSHMS me shkresën nr. 10417, datë 12.11.2020 dhe protokolluar në MSHMS me nr. 4716, datë 17.11.2020, nëpërmjet të cilës dërgon Planin Social të Bashkisë dhe VKB përkatëse, NIPT-in, si dhe projekt propozimin. Ndërkohë në dosjen e vënë në dispozicion, administrohet gjithashtu shkresa me nr. 10417, datë 13.11.2020, e sigluar nga Titullari i Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë, në emër të Kryetarit të Bashkisë, ku krahas sa më lart janë shtuar edhe dokumentet e nevojshme të partnerit (Nismës A). Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se nuk është e qartë se kujt i drejtohet shkresa e mësipërme, ajo nuk përmban vulën e institucionit, nuk është e protokolluar në MSHMS dhe përmban të njëjtin nr. protokoll me shkresën e dërguar nga titullari i Bashkisë Vlorë dërguar një ditë më parë. Po kështu, nga auditimi rezultojnë se CD e bashkëlidhur shkresës së Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, është bosh dhe nuk përmban asnjë nga dokumentet që citohen në shkresë. Së fundmi, sa i takon projekt propozimit, në dosje gjendet dokumenti "Deklaratë Partneriteti", me anë të të cilës palët kanë shprehur vullnetin për të aplikuar si partnerë në projekt propozimin e dërguar MSHMS. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti, rezultojnë se ai daton më 13.11.2020 dhe mban nënshkrimin e	E Lartë	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 1) faqe (17) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i>	Bashkia Vlorë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresore zyrtare në shkëmbimet mes njëjësive.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë, në emër të Kryetarit të Bashkisë dhe nuk është i protokolluar në BV. Nga auditimi rezultoi se ky dokument nuk përfshihet në listën e dokumenteve të cituara në shkresën e Kryetarit të Bashkisë, e cila ligjërisht përmban të gjithë elementët e një shkrese zyrtare, pra konstatohet se më datë 12.11.2020 kur është dorëzuar zyrtarisht aplikimi për Fondin Social, nuk ka patur partneritet me ndonjë organizatë mbështetëse.			
4.	<p>Nga auditimi i minutave të takimit të zhvilluar midis Bashkisë Korçë dhe Nismës A më datë 20.05.2021 dhe 21.05.2021, u konstatua se termat e marrëveshjes së bashkëpunimit janë dakordësuar midis palëve, ku bashkia angazhohet për një rishikim final para miratimit të kësaj të fundit në Këshillin Bashkiak. Konstatohet gjithashtu se grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion procedura e dakordësimit të tekstit të marrëveshjes nga palët si edhe miratimi final i këtij teksti, i cili në vijim është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Korçë. Nga një rishikim formal i tekstit të kësaj marrëveshje vërehet se ka një mungesë konsistence në dy elementë të këtij dokumenti: numri i faqeve dhe aneksi bashkëlidhur marrëveshjes. Lidhur me elementin e parë konstatohet se kjo marrëveshje duhet të përmbajë 8 faqe (nisur nga fakti se faqja e parë e saj është emërtuar 1 nga 8), ndërkohë që rezulton se, pas faqes 8 nga 8 vijohet me faqen 8 nga 9 dhe përsëri 8 nga 8 e 8 nga 9 (pra është shtuar një faqe dhe këto dy faqe përsëriten). Marrëveshja mbyllet me firmat e palëve dhe faqja është pa numër, ndërkohë që firmat e palëve gjenden edhe në faqen 7 nga 8. Lidhur me elementin e dytë, konstatohet se - referuar nenit 10, pika vi) Dispozita të Funditë ku thuhet se pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe Aneksi 1 Tabela me zërat e buxhetit - faqet në vijim 8 nga 8 dhe 8 nga 9 nuk kanë emërtimin Aneksi 1 sikundër kërkohet nga vet marrëveshja. Konstatimet sa më lart evidentojnë faktin se një dokument i tillë mund të jetë lehtësisht i manipulueshëm.</p> <p>Sa i takon aplikimit të Bashkisë Korçë për përfitimin e fondeve nga fondi social është konstatuar se deklarata e partneritetit paraqitur së</p>	E Lartë	<i>(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 2) faqe (26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Bashkia Korçë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresorë zyrtare në shkëmbimet mes njësive.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>bashku me këtë aplikim me nr. 8975, prot., datë 13.11.2020 është nënshkruar nga Bashkia Korçë (në mungesë dhe me porosi znj. B.TH.), ndërsa në vendin e nënshkrimit dhe vulosjes së këtij dokumenti nga ana e Nismës Afirma e Drejtorit Ekzekutiv së bashku me vulën janë të skanuara dhe jo origjinale, Deklarata nuk është nënshkruar njëkohësisht nga të dyja palët, në kundërshtim me normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu bashkëlidhur aplikimit është vendosur CD i aplikimit i cili është bosh.</p>			
5.	<p>Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma ApërōTrajnime stafi, mentorime dhe supervizimeō. Nga Bashkia Vlorë është paguar në total vlera 902,000 lekēdhe nga Bashkisē Korçē është paguar vlera 877,000 lekē. Kēto pagesa nuk duhet tē ishin kryer nga tē dy bashkitē pilot pēr sa mē poshtē:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Referuar urdhr̄it tē Ministr̄it tē MSHSM nr.548 datē 01.10.2020 ōPēr ngr̄itjen dhe funksionimin e Komitet̄it Drejtues pēr zbatim̄in e planit kombētar tē deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit tē Veprim̄it pēr Zbatim̄in e tijō zbatimi i planit tē deinstitutionalizimit do tē jetē pērgjegjēsi e Grupit Teknik tē Punēs (GTP) nē me Komitet̄in Teknik tē ngr̄itur pranē MSHMS. GTP është i pērbērē nga pērfaqēsues tē MSHMS, pērfaqēsues nē Shērbimit Social Shtetēror, pērfaqēsues tē ASHDMF-sē, Ekspertē tē jashtēm tē kontraktuar nga partnerēt ndērkombētar dhe tē tjerē sipas nevojēs por nga sa u konstatua pērveç Nisma A pēr ofrim̄in e kētyre shērbimeve nuk është pērfshirē asnjē anēt̄ar tjetēr i GTP-s siç edhe duhet tē ishte pēr zhvillimin e modeleve sa mē cilēsore.</li><li>- Ekspertē tē jashtēm tē OJF Nisma A si pjesē e GTP-s janë tē kontraktuar nga partnerēt</li></ul>	E Lartē	<p><i>(Mē hollēsisht trajtuar nē pikēn (III. 2. 3) faqe (36) tē Raportit Pērfundimtar tē Auditimit)</i></p>	<p>Nga Bashkia Korçē, tē kērkohet nē rrugē ligjore duke ndjekur tē gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe tē gjitha shkallēt e gjykimit, arkētimi i vlerēs <b>877,000 lekē</b>, si pasojē e pagesave tē kryera padrejtēsisht pēr shērbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatēs Nisma A.</p> <p>Nga Bashkia Vlorē, tē kērkohet nē rrugē ligjore duke ndjekur tē gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe tē gjitha shkallēt e gjykimit, arkētimi i vlerēs <b>902,000 lekē</b>, si pasojē e pagesave tē kryera padrejtēsisht pēr shērbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatēs Nisma A.</p>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë shërbime për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga dy bashkitë pilot. Bashkia Korçë dhe Vlorë nuk duhet të realizonin pagesa për shpenzime trajnimesh, mentorime dhe supervizime kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save the Children do të jetë për <u>mbështetje teknike ndaj këtij plani</u>, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë <u>përfutues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.</u></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar sipas emërimit, orëve dhe çmimit për orë pune nga vetë Bashkitë.</li></ul> <p>Nga sa më sipër, Nisma A ka përfutuar padrejtësisht pagesën prej 1,779,000 lekë për trajnime, mentorime dhe supervizime për të dy bashkitë pilot.</p>			
6.	<p>Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma Apërdraft dokumentet “Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit. Nga Bashkia Vlorë me urdhër shpenziminnr. 1472 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë dhe nga Bashkisë Korçë me urdhër shpenzimit nr. 1570 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishin kryer nga të dy bashkitë pilot për sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Referuar pikës 3.5 të urdhrit të Ministrisë të MSHSM nr.548 datë 01.10.2020 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit</li></ul>	E Lartë	<p><i>(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 3) faqe (36) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i></p>	<p>Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës <b>325,000 lekë</b>, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit ndaj organizatës Nisma A.</p> <p>Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës <b>325,000</b></p>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>të Veprimit për Zbatimin e tij këto materiale janë përgjegjësi e GTP dhe do të miratohen nga Komiteti Drejtues.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në nenin 4 të marrëveshjeve të bashkëpunimit Bashkive dhe Nisma A: përcaktohet se këto materiale duhet të miratohen nga Bashkitë respektive të cilat rezultoi se ishin draft dokumente dhe të pa miratuara.</li><li>- Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A të cilët kanë hartuar: “<i>Termet e referencës për ngritjen e Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen, Protokollat, manualat e shërbimit përfshirë mekanizmat e llogaridhënies, Udhëzimi i pilotimit të shërbimit të kujdesit në familje</i>” dhe janë pjesë e GTP-s, duhet të kishte rol mbështetës për këtë plan si të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe jo të paguhet për shërbimet e realizuara në këto bashki pilot.</li><li>- Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar nga vetë Bashkitë.</li></ul> <p>Nga sa më sipër, Nisma A ka përfutur padrejtësisht pagesën prej 650,000 lekë për draft dokumentet e prodhuara për dy bashkitë pilot.</p>			<p><b>lekë</b>, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për dhartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit ndaj organizatës Nisma A.</p> <p>Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Grupi Teknik i Punës dhe Komiteti Drejtues të merren për rishikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit. Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot, në mënyrë të tillë, që nëse ky plan rezulton i suksesshëm në dy bashkitë pilot të vijojë të ndiqet në nivel kombëtar. Prandaj përfshirja e anëtarëve të GTP në hartimin e këtyre dokumenteve dhe miratimi i dokumenteve nga Komiteti Drejtues është proces shumë i rëndësishëm.</p>
7.	<p>Nga auditimi i zbatimit të planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga Bashkia Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma A me urdhër shpenzimin nr. 1572 datë 28.12.2021 për shpenzimet: dhMenaxhim shërbimiö në vlerën 180,000 lekë, dhOficer financeö në vlerën 150,000 dhe dhLogjist/shoferö në vlerën 80,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishte kryer nga Bashkia Korçë për sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A si pjesë e GTP-s janë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë</li></ul>	E Lartë	<p><i>(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 3) faqe (36) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i></p>	<p>Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës <b>410,000 lekë</b>, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për dhmenaxhim shërbimiö, dhoficer financeö dhe dhshoferö ndaj organizatës Nisma A.</p>





**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>shërbime për zbatimin e planit të Deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga bashkia pilot. Bashkia Korçë nuk duhet të realizonte pagesa për shpenzime të Menaxhim shërbimi, të Oficerit financë dhe të Logjist/shoferit kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save the Children do të jetë për mbështetje teknike ndaj këtij plani, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë përfitues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Në kontratat e punësimit të këtyre punonjësve të hartuara nga nisma A nuk është përfshirë bashkia si palë interesi dhe si përfituese e këtij shërbimi por është mjaftuar vetëm në kontratat e lidhura nga Nisma A me punonjësit. Gjithashtu shërbimi që është ofruar nga Oficeri Financë dhe Logjist/Shoferi nuk dokumentohet nga Bashkia Korçë.</li></ul> <p>Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 410,000 lekë për shërbime të kryera nga personeli i punësuar prej saj, për një punë të pa dokumentuar dhe pa detyrime juridike për Bashkinë Korçë.</p>			

### **I. 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Vlerësimi i auditimit**

Nga auditimi i zhvilluar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Vlorë u konstatuan mangësi dhe problematika të cilat kanë cenuar zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022,

Më konkretisht, është konstatuar:

- miratim dhe zbatim me vonesë i VKM ó së dhe tentativat për rishikimin e këtij akti ende nuk janë konkretizuar me një ndryshim të tij, me efektin e vetëm të mos zbatimit në kohë të shumicës së objektivave të përcaktuara në të, sidomos sa i takon objektivave që kanë të bëjnë me përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator.

- Komiteti Drejtues për Deinstitutionalizimit, i përbërë nga 13 anëtarë, nuk ka vepruar si strukturë udhëheqëse në nivel kombëtar për zbatimin e këtij plani, sidomos nisur edhe nga fakti se institucionet e përfshira në të. Ky Komitet nuk ka rezultuar të ketë përmbushur objektivin e vet, për aq kohë sa dy Bashkitë në të cilat po zbatohet projekti pilot u mungonte orientimi dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

udhëheqja e detajuar për këtë qëllim, sidomos për sa i takon miratimit të produkteve të prodhuara nga partneri vendor në zbatim të planit.

- Të dy bashkitë e projektit pilot, Bashkitë Vlorë dhe Korçë kishin mangësi në kuptimin e drejtë të implikimeve që ky proces do të sillte në organizimin e shërbimeve alternative për fëmijën dhe familjen, për më tepër kur, në kontekstin e mungesës së një plani specifik të transformimit të strukturave ekzistuese, është proceduar me ngritjen e shërbimit për mbështetjen e fëmijës dhe familjes.

- Auditimi nxori në pah edhe inkoherenca në rrugën e zgjedhur për të hartuar termat, manualet dhe standardet për zbatimin e deinstitutionalizimit dhe parandalimin e institutionalizimit në vendin tonë, si në këndvështrimin e financimit të aktiviteteve ashtu edhe në atë të realizimit të disa objektivave specifik në këtë sens, siç është krijimi i kujdestarisë alternative profesionale. Gjithashtu është evidentuar mungesë totale transparence si nga Bashkitë e projektit pilot dhe nga MSHMS në përzgjedhjen e partnerit lokal Nisma për ndryshim shoqëror A.

- Lidhur me aspektin financiar, problematikat kryesore lidhen me aplikimin për përfitim të fondit social nga dy bashkitë e projektit pilot dhe ekzekutimin e shpenzimeve të tyre. Të dy bashkitë kanë realizuar shpenzime për trajnime, pagesa për manuale dhe pagesa për staf nga fondi social, të cilat janë të pajustificuara, nisur edhe nga fakti se ky fond iu është akorduar këtyre institucioneve për ngritjen e shërbimit mbështetës për fëmijën dhe familjen.

- Gjithashtu, secila bashki ka paguar OJF ó në partner në këtë iniciativë për të njëjtat produkte trajnime, manuale dhe standarde, në mungesë të një procesi diskutimi mbi përmbajtjen e tyre dhe në mungesë të një miratimi paraprak nga strukturat e vetë bashkive apo nga vet Komiteti Drejtues, duke konsideruar që këto dokumente duhet të shtrihen për zbatim në rang vendi.

**Nisur nga sa më lart, qartas del në pah se niveli aktual i implementimit të Planit të Deinstitutionalizimit nuk favorizon zbatimin në një shkallë më të gjerë të tij, duke qenë se synimi është shtrirja e konceptit të deinstitutionalizimit edhe në kategori të tjera të individëve në nevojë të cilat aktualisht marrin shërbim rezidencial në vendin tonë. Përgjithësisht është evidentuar mungesë koordinimi dhe ndërveprimi midis institucioneve të përfshira në zbatimin e tij, kjo edhe për shkak të mungesës së një vizioni të përbashkët dhe të përgjithshëm për rezultatet afatgjata të tij.**

#### Pretendimet e Subjektit

*Lidhur me sa më sipër MSHMS ka dërguar observacionet me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet mos dakordësia lidhur me një nga paragrafet e konkluzionit të përgjithshëm: “Komiteti Drejtues për Deinstitutionalizimin i ngritur me urdhrin nr. 548, datë 01.10.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 – 2022”<sup>1</sup>, i përbërë nga 13 anëtarë, nuk ka vepruar si strukturë udhëheqëse në nivel*

<sup>1</sup>Ky komitet kryesohet nga Zv/Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka përfaqësues nga MSHMS, SHSSH, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, UNICEF, Save the Children, Bashkitë Tiranë, Korçë, Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Shkodër, si dhe përfaqësues nga Grupi Teknik i Punës si vijon: Albert Nikolla Zv. Ministër; M.XH., Drejtor i Përgjithshëm në MSHMS; L.S., Drejtor i Përgjithshëm i SHSSH; A.T., Kryetare e ASHDMF; A.S., Bashkia Tiranë; I.Z., Drejtor Bashkia Korçë; M.XH., Bashkia Durrës; F.V. Drejtor Bashkia Shkodër; I.S., Drejtor Bashkia Vlorë; UNICEF; Save the Children, Z.K., Përfaqësues i Grupit Teknik të Punës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*kombëtar për zbatimin e këtij plani, sidomos nisur edhe nga fakti se institucionet e përfshira në të, si për shembull Shërbimi Social Shtetëror nuk janë përfshirë direkt apo plotësisht në zbatimin e këtij plani. Ky Komitet nuk ka rezultuar të ketë përmbushur objektivin e vet, për aq kohë sa dy Bashkitë në të cilat po zbatohet projekti pilot u mungonte orientimi dhe udhëheqja e detajuar për këtë qëllim, sidomos për sa i takon miratimit të produkteve të prodhuara nga partneri vendor në zbatim të planit. Gjithashtu është evidentuar mungesë totale transparence si nga Bashkitë e projektit pilot dhe nga MSHMS në përzgjedhjen e partnerit lokal Nisma për ndryshim shoqëror A.” Për këtë paragraf kontestimet janë si më poshtë:*

*1. Komiteti ka realizuar punën e tij të dokumentuar me minutat përkatëse të takimit për dy takimet e zhvilluara në vitin 2020 si dhe rezulton se SHSSH, drejtuesit dhe stafet sociale të Bashkive Korçë dhe Vlorë janë asistuar dhe mirëorientuar për realizimin e procesit të deinstitutionalizimit i cili sapo ka filluar dhe ka ende shumë rrugë për tu përfunduar.*

*2. SHSSH monitoron zbatimin e standardeve kombëtare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit (në rastin konkret 9 IPSH – të, si dhe 2 shërbimet e ngritura në dy bashkitë pilot të financuara në kuadër të Fondit Social.*

*3. Në këtë kontekst kërkohet riformulimi i paragrafit pasi Komiteti në harkun kohor 1 vjeçar, nëpërmjet dy takimeve të realizuara ka mundur të kalojë në diskutim dhe shqyrtim disa dokumente të rëndësishëm për të filluar procesin e deinstitutionalizimit (manuale, udhëzues, modele të reja shërbimesh alternative). SHSSH dhe dy bashkitë nuk kanë pasur komente apo sugjerime lidhur me to.*

*4. Kërkohet të mos trajtohet në raportin final të auditimit komenti “Shërbimi social shtetëror nuk është përfshirë direkt apo plotësisht në zbatimin e këtij plani”.*

*Lidhur me komentin: “është evidentuar mungesë totale transparence si nga Bashkitë e projektit pilot dhe nga MSHMS në përzgjedhjen e partnerit lokal Nisma për ndryshim shoqëror A.” Subjekti sqaron se partneri është kontraktuar nga UNICEF sipas procedurave të agjencive të specializuara të UN. Pra, procedura e përzgjedhjes nuk varet nga mungesa e transparencës, as MSHMS as nga vetë Bashkitë Korçë dhe Vlorë. Lidhur me këtë gjë MSHMS i ka kërkuar grupit të auditimit ti drejtohet zyrtarisht UNICEF – it për organizimin e një takimi sqarues me ekipin e KLSH për përzgjedhjen e A. Kjo kërkesë ka ardhur pasi nga MSHMS u komunikua me UNICEF dhe u treguan të gatshëm për një takim, por nga KLSH nuk u iniciua kërkesë zyrtare.*

#### Qëndrimi i grupit të auditimit:

*Sa i takon komentit të parë dhe riformulimit të tij pasi SHSSH dhe Bashkitë Korçë dhe Vlorë janë mirëorientuar dhe asistuar gjatë zbatimit të planit sipas pretendimeve të subjektit, sqarojmë se observacioni nuk pranohet, pasi nga auditimi në terren dhe përgjigjet e dokumentacionet e marra nga subjektet e përfshira në këtë auditim është evidentuar pikërisht mungesë koordinimi dhe orientimi e specializuar nga ky komitet.*

*Sa i takon komentit të dytë sqarojmë se grupi i auditimit është në dijeni të detyrimeve ligjore të SHSSH lidhur me monitorimin e zbatimit të standardeve kombëtare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit (në rastin konkret 9 IPSH – të, si dhe 2 shërbimet e ngritura në dy bashkitë pilot të financuara në kuadër të Fondit Social.*



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*Sa i takon komentit të tretë sqarojmë se Komiteti ka diskutuar në parim nevojën e hartimit të këtyre dokumenteve si domosdoshmëri e nisjes së procesit, por nuk ka konkluduar me miratimin final tyre. Fakti që SHSSH dhe bashkitë e pilotuara nuk kanë pasur komente për materialet e propozuara nuk tregon angazhim nga ana e tyre duke marrë edhe në konsideratë faktin që dokumente ishin dhe ende janë nën pilotim, si edhe faktin që të gjitha palët ishin pjesë e Grupit teknik të punës. Rikujtojmë se individët e caktuar nga institucionet e përfshira në këtë grup janë ngarkuar nga Urdhri i Ministrit nr. nr. 548, datë 01.10.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 – 2022” për të hartuar pikërisht këto dokumente. Dmth, sistemi i krijuar për zbatimin e planit parashikon në nivel qendror Komitetin, në nivel teknik Grupin teknik të punës përgjegjës për hartimin e një liste dokumentesh, e në nivel vendor SHMFF për pilotimin konkret të materialeve të prodhuara. Në një këndvështrim procesi, fakti që në qasjen bottom – up nuk ka pasur komente për përmirësim apo ndryshim të dokumenteve të propozuara nuk është dicka për tu përgëzuar. Gjithashtu është evidentuar angazhim më i madh i partnerit në hartimin e dokumenteve se sa i individëve të tjerë të caktuar si anëtar në GTP.*

*Lidhur me komentin e katërt sqarojmë, sikundër i kemi sqaruar edhe subjekti gjatë auditimit, UNICEF nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë subjekt i auditimeve të KLSH.*

## II. HYRJJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1267/1 prot., datë 22.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.11.2021 deri më datë 14.02.2022 u kryer auditimi i përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar për Deinstitutionalizimin e fëmijëve 2020 – 2022 në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Shërbimin Social Shtetëror, në Bashkinë Korçë dhe Vlorë për periudhën 01.09.2020 - 30.11.2021, nga Grupi i Auditimit mepërbërje:

1. XH.Ç., Përgjegjëse grupi;
2. R. K., anëtare;
3. A.N., anëtare;
4. I. H., anëtar;
5. A.K., anëtar.

### II. 1. Objektivi i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.

Objektivi i Auditimit është vlerësimi dhe dhënia e opinionit mbi masat e marra për procesin e deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të perkujdesit shoqëror për fëmijë nga institucionet përkatëse në nivel qendror (MSHMS dhe SHSSH), si dhe nga institucionet e vetëqeverisjes vendore të përfshira në fazën e projektit pilot, Bashkitë Korçë dhe Vlorë.

### II. 2. Qëllimi i Auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

me kuadrin rregullator në fuqi, mbi bazën e të cilit është hartuar Plani Kombëtar për Deinstitutionalizimin 2020 - 2022 dhe janë zbatuar objektivat që i përkasin periudhës nën auditim.

#### **II. 3. Identifikimi i çështjes**

Raporti ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- plotësinë e kuadrit rregullator në funksion të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit;
- zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022;
- auditimin e shpenzimeve të kryera në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022.

#### **II. 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

#### **II. 5. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, shprehur nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj.

#### **II. 6. Kriteret e vlerësimit**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI).
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.
- ISSA 4000 - 4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë.
- ISSAI 400 - 499 Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë.
- "Libri Jeshil" i GAO-s, etj;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 për "Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",
- Konventa për të drejtat e fëmijës
- Ligj nr. 121/2016 òPër shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligj nr. 8153, date 31.10.1996 "Për statusin e jetimit"; si dhe akte të tjera ligjore që lidhen me fokusin e auditimit.
- Ligj nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- VKM nr. 706, datë 09.09.2020 òPër miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020 ó 2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij;
- VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror".
- VKM nr. 111, datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social";
- si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me fokusin e auditimit.

#### II. 7. Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme òMbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. nr. 97, datë 30.09.2020; Rregullorja e Brendshme òPër procedurat e auditimit të KLSH; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 63, datë 22.06.2020 ò Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-tò (ISSAI), òStandardet e Kontrollit të KLSH, òManualeve si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

#### II. 8. Metodat e auditimit

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

*Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

*Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

*Verifikimi në sistem* me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

#### II. 9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e subjekteve të audituara, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet, takimin përmbyllës në terren dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij raporti.

### III. PËRSHKRIMIAUDITIMIT

#### III. 1 Mbi plotësinë e kuadrit rregullator në funksion të procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit

**Titulli i gjetjes nr. 1: Implementimi i Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit dhe Planit të Veprimit në zbatim të tij, miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, është zbatuar me mangësi.**

**Situata:** Plani i veprimit është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në kuadër të Reformës së Shërbimeve të Kujdesit Social, dhe me mbështetjen teknike të UNICEF-it. Dokumenti politik është konsultuar me grupet e interesit, shoqërinë civile, donatorë, partnerë dhe institucionet përgjegjëse në Shqipëri, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Brendshme dhe organizatat e tjera. Ky plan është hartuar në kuadër të detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2020-2022)<sup>2</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se, Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit dhe Plani i Veprimit në zbatim të tij, miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, duhet të zbatohet që nga muaji Janar 2020, ndërkohë që është miratuar në Shtator 2020 nga Këshilli Ministrave. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS nuk është konkluduar rivendosja në afat e Planit Kombëtar për Deinstitutionalizimin dhe efektet e tij, duke krijuar konfuzion si në zbatimin e afateve, po ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë plan. Janë diskutuar afatet e reja të zbatimit të këtij plani dhe janë përfshirë në Progres raportin e vitit 2021 të miratuar nga Komiteti në janar të vitit 2022, por këto ende nuk janë reflektuar në përditësimin e tij.

**Kriteri:** Veprime në kundërshtim me VKM nr. 706, datë 09.09.2020. ÷Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij.

**Ndikimi/Efekti:** Mos marrja e masave për rivendosjen në afat të zbatimit të Planit të Veprimit, ka sjell çoroditje si në zbatimin e afateve, po ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë plan, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e zbatimit të PKD.

**Shkaku:** Mos zbatim i kriterëve të vendosura nga kuadri ligjor për implementimin dhe zbatimin e PKD dhe Planit të Veprimit në zbatim të tij.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të integruar Planin e Veprimit me afatet e rivendosura me Progres raportin e vitit 2021, miratuar në janar të vitit 2022, me qëllim zbatimin e Planit të Veprimit në kohë dhe me cilësi.

*Subjekti i audituar ka paraqitur observacion me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe*

<sup>2</sup>Vendim nr. 706, datë 9.9.2020 Për miratimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit, 2020-2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij.



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet:*

**Pretendimet e subjektit:** Sqarojmë se konstatimi është i pasaktë. Grupi teknik për deinstitutionalizimin, i ngritur ne zbatim të urdhrimit të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 548, dt.01.10.2020, ka riparë dy herë afatet e zbatimit të planit, reflektuar në Progres Raportin për vitin 2020 të miratuar në Komitetin Drejtues për Deinstitutionalizimin, janar 2021, janë miratuar edhe ndryshimet e propozuara nga Grupi Teknik për rivendosjen e afateve të zbatimit të Planit të Veprimit të PKD. Gjithashtu në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Fëmijëve, janar 2022, është miratuar Progres Raporti 2021 I PKD-së, i cili përmban edhe propozimet për rivendosje të afateve.

**Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: përpjekjet institucionale për të rivendosur në afat Planin e Veprimit në zbatim të PKD, nuk janë pasqyruar ende në Planin e Veprimit, këto komente do të merren në konsideratë pjesërisht dhe do të kërkohet reflektimi i afateve të reja sipas Progres Raportit 2021 në Planin e veprimit.

#### **Titulli gjetjes nr. 2: Nuk janë zbatuar të gjitha objektivat e përcaktuara në Planin e Veprimit.**

**Situata:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS nuk janë zbatuar të gjitha detyrimet e përcaktuara në Planin e Veprimit të miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, òPër miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij, dhe konkretisht të objektivit:

1. Harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural që siguron zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës.

*1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor të shërbimeve shoqërore, për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve:*

a) Analizë/studim i kuadrit ligjor ekzistues/evidentimi i ndryshimeve të nevojshme në legjislacion, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve për profesionistë. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020

Grupit të auditimit nuk i janë paraqitur dokumente që vërtetojnë realizimin e këtij objektivi.

*Subjekti ka paraqitur observacion me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet*

**Pretendimet e subjektit:** Analiza ligjore e realizuar është konsultuar me stafet sociale në nivel qendror dhe vendor, gjatë një takimi me profesionistë, 24 shkurt 2020. Sqarojmë se dy modele të reja shërbimi janë hartuar, po pilotohen ndërkohë që po bëhet edhe kostimi real i tyre duke u bazuar në praktikë. Dokumentet bashkëlidhur plotësimi të pyetësorit të hartuar nga ky ekip, bazuar në planin e masave të deinstitutionalizimit.

**Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar dhe dokumentacionit shtesë të vendosur në dispozicion obacioni do të merret në konsideratë dhe objektivi 1.1 germa a) do të quhet i realizuar.

b) Hartimi i ndryshimeve ligjore, administrative dhe procedurale, bazuar në rekomandimet e studimit. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020





## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

- Janë propozuar ndryshime për Ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, òKodi i Familjesò, të ndryshuarò
  - Janë propozuar ndryshime për Ligjin nr. 9695, datë19.3.2007 òPër procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimitò, të ndryshuarò
  - Ndryshimet ligjore në zbatim të objektivit 1 të planit DEI, me propozim të MD, që e ka në fushën e përgjegjësisë, aktualisht janë miratuar nga Qeveria dhe janë për miratim në parlament. (procesi i miratimit është bllokuar pas ndërhyrjes së shoqërisë civile).
  - c) Konsultimi me ministrinë e linjës, agjencinë zbatuese dhe grupet e interesit, draftin e ndryshimeve ligjore të propozuara. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020
- Grupit të auditimit nuk i janë paraqitur dokumente që vërtetojnë realizimin e këtij objekti.

*Subjekti ka paraqitur observacion me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet:*

**Pretendimet e subjektit:** Modelet e reja të shërbimeve, draft udhëzimet, si edhe materiale të tjera janë konsultuar në Konferencën Kombëtare për progresin e arritur dhe sfidat e reformës së De-I, e cila u organizua më 19 Nëntor 2021, ku morën pjesë të gjithë profesionistët socialë që operojnë, ofrojnë shërbime ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror, nga të gjitha institucionet rezidenciale të përkujdesit social, që janë dhe pjesë e reformës.. Gjatë konferencës u hodhën propozime të ndryshme për përmirësimin e reformës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, përfshirë këtu dhe ndryshimet e mundshme të disa akteve normative, e për këtë arsye sugjerojmë riformulimin e objektivit si realizuar pjesërisht.

**Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

- Në këtë pikë bëhet fjalë për detyrat që Plani i Veprimit i ka ngarkuar institucionit tuaj, dhe jo për detyra që u janë ngarkuar institucioneve të tjera.(referohuni objektivit, 1.1, germa "c"). Nga verifikimet e kryera rezulton se kjo detyrë nuk është realizuar, prandaj këto komente nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

- d) Hartimi i akteve nënligjore/moduleve dhe udhëzuesve sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020
- Grupit të auditimit nuk i janë paraqitur dokumente që vërtetojnë realizimin e këtij objekti, prandaj ky objektivi do të konsiderohet i pazbatuar.

*Subjekti ka paraqitur observacion me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet:*

**Pretendimet e subjektit:** Janë hartuar dhe diskutuar në mbledhjen e dytë të Komitetit Drejtues draft udhëzuesit specifikë për Bashkitë, Shërbimin Social Shtetëror si edhe për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Këta udhëzues do të diskutohen dhe njëherë dhe miratohen në mbledhjen e radhës të Komitetit Drejtues të De institucionalizimit. Kërkohej evidentimi i objektivit si i realizuar pjesërisht.

**Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: nga verifikimi rezulton se produkti final mungon, prandaj këto komente nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*1.2 Rregullimi i kuadrit financiar të shërbimeve të reja të përkujdesjes shoqërore të modeluara në kuadër të de institucionalizimit:*

a) Hartimi dhe kostimi i paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020

Grupit të auditimit nuk i janë paraqitur dokumente që vërtetojnë realizimin e këtij objekti, prandaj ky objektiv do të konsiderohet i pazbatuar.

b) Hartimi dhe kostimi i modeleve të reja të shërbimit sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020

c) Hartimi dhe kostimi i programit të ribashkimit të fëmijës me familjen.

d) Hartimi i udhëzuesit për bashkitë për të planifikuar dhe aplikuar në kuadër të Fondit Social për ngritjen e shërbimeve që synojnë ribashkimin e fëmijës. Parashikuar të realizohet gjatë periudhës kohore Janar 2020 ó Dhjetor 2020

**Kriteri:** Veprime në kundërshtim me VKM nr. 706, datë 09.09.2020. òPër miratimin e Planit Kombëtar të De institucionalizimit, 2020ó2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij.

**Ndikimi/Efekti:** Mos marrja e masave për zbatimin në afat të Planit të Veprimit, ka sjell vonesë në arritjen e objektivave të PKD dhe të objektivave të qeverisë, duke shkaktuar ngadalësim të procesit të deinstitutionalizimit.

**Shkaku:** Mos zbatim i kriterëve të vendosura nga kuadri ligjor për implementimin dhe zbatimin e PKD dhe Planit të Veprimit në zbatim të tij.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të realizuar në afat dhe me cilësinë e kërkuar objektivat e caktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e PKD.

*Subjekti ka paraqitur observacion me shkresën nr. 430/2, prot., datë 05.05.2022 dhe protokolluar me tonën me shkresën nr. 1267/19, prot., datë 06.05.2022 ku shprehet:*

*Pretendimi i subjektit: Kërkohet nga subjekti i auditimit rishikimi i afateve të rekomandimeve të lëna pasi Plani Aktual i Deinstitutionalizimit do të ketë një kohëzgjatje të re tre vjeçare nga 2023 – 2025.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Kërkesa do të merret në konsideratë brenda qëllimit dhe objektivit të këtij auditimi për të nxitur subjektin në realizimin e qëllimeve të veta strategjike dhe operative për deinstitutionalizimin.*

**Titulli i gjetjes nr. 3: Shërbimi Social Shtetëror, nuk është pjesëmarrës aktiv në implementimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit dhe Planin e Veprimit në zbatim të tij.**

**Situata:** Nga përgjigja e marrë nga SHSSH-ja ndaj kërkesës për informacion, për detyrat dhe rolin e këtij institucioni në Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit, u konstatua se, ky institucion nuk është përfshirë direkt, por në një rol dytësor e pak të rëndësishëm. Në e-mail-n e tyre drejtuar grupit të auditimit ata sqarojnë se; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror është pjese e komitetit drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 (Urdhër nr. 548 date 01.10.2020 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale). Marrëveshja për bashkëpunim është lidhur midis organizatës Nisma për ndryshim shoqëror/ A,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Bashkive ne te cilat do te zbatohet procesi, institucioneve dhe Drejtorive Rajonale te Shërbimit Social Shtetëror. Ne këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social shtetëror ka rolin e vetëm te zbatoje moratoriumin sipas objektivit te dyte te planit te DI qe do te thotë qe rastet e fëmijëve ne risk te larte referuar nga strukturat përgjegjëse te bashkive Korçë dhe Vlore te mund te sistemohen ne Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të tjera për fëmijë, për t'ju ofruar mbrojtje te menjëhershme.

Për çdo info që do t'ju duhet Drejtoritë tona Rajonale Vlore dhe Korçë do t'ju vënë në dispozicion çfarë ata kane.<sup>3</sup>

**Ndikimi/Efekti:** Mos përfshirja direkte e SHSSH, dhe mos angazhimi mi saj me detyra konkrete për zbatimin e objektivave të Planit të Veprimit, ka sjell njëanshmëri në zbatimin e PKD-së, dhe është në dëm të të gjithë procesit të deinstitutionalizimit.

**Shkaku:** Mos vlerësimi i rolit të SHSSH në procesin e deinstitutionalizimit nga hartuesit e PKD.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marri masa për të inkuadruar dhe ngarkuar me detyra konkrete SHSSH në procesin e realizimit të objektivave të Planit të Veprimit për deinstitutionalizimin.

*Lidhur me sa më sipër subjekti ka paraqitur observacionin nr. 723/1, prot., datë 27.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 1267/15, prot., datë 29.04.2022 ku thuhet se Shërbimi Social Shtetëror si aktor në zbatimin e deinstitutionalizimit luan një rol të rëndësishëm në ecurinë e këtij procesi duke marrë masa për parandalimin e deinstitutionalizimit të fëmijëve të moshave nga 0 – 18 vjeç, duke theksuar që në IPSH – të Korçë dhe Vlorë nuk ka lejuar sistemime të reja të fëmijëve.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni nuk pranohet, pari është konstatuar nga grupi i auditimit thyerje e moratoriumit në IPSH – në e Vlorës dhe institutionalizim i dy fëmijëve përkatësisht në dhjetor 2021 dhe janar 2022 gjatë kohës që grupi i auditimit ishte prezent në IPSH – në e Vlorës.*

Në argumentimin gjetjeve, grupi i auditimit u bazua edhe në Raport Progresin e vitit 2021, për Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022, raport i cili është hartuar nga Grupi Teknik i Punës (GTP), i ngritur bazuar në urdhrin e Ministrit të MSHMSóssë, datë 01.10.2020, për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, i cili në mënyrë të pjesshme, paraqitet më poshtë:

*Matrica e monitorimit të zbatimit të planit (viti 2020)*

*Vlerësimi i masave sipas nivelit të realizimit:*

<sup>3</sup>E-mail, datë 05.01.2022, Aida Çavo, ZV Drejtor i Përgjithshëm Shërbimit Social Shtetëror



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural që siguron zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës	Produkti	Progresi			Komente/ shënime/ sqarime	Afati i planifikuar	Afati i riparë
		R	N P	N F			
		R	N P	N F			
<b>1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor të shërbimeve shoqërore, për mbrojtjen dhe përkujdesin e fëmijëve.</b>	Kuadri ligjor i rishikuar						
a) Analizë/studim i kuadrit ligjor ekzistues/ evidentimi i ndryshimeve të nevojshme në legjislacion, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve për profesionistët.	Dokumenti i analizës ligjore				Analiza është një proces në vazhdimësi. Në vitin 2021 është analizuar baza ligjore për ngritjen e shërbimeve të reja, me në qendër familjen, me bazë komunitare. Komentet për ligjin e birësimit dhe	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022
b) Hartimi i ndryshimeve ligjore, administrative dhe proceduriale bazuar në rekomandimet e studimit	Aktet normative të hartuara				Ligji për Birësimet dhe Kodi i familjes të riparë janë në parlament.	Maj 2021	Dhjetor 2022
c) Konsultimi me ministrinë e linjës, agjencitë zbatuese dhe grupet e interesit i draft	Tryeza teknike, komunikime zyrtare				Konsultimet janë zhvilluar online sa herë që ka pasur nevojë.	Maj 2021	Dhjetor 2022

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË**

ndryshimeve ligjore të propozuara.						
d) Hartimi i akteve nënligjore/moduleve dhe udhëzuesve sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë	Aktet nënligjore/Model et e reja të hartuara dhe miratuara				Janë hartuar draft udhëzimet për institucionet shtetërore në zbatim të deinstitutionalizimit.	Maj 2021 Dhjetor 2022
<b>1.2 Rregullimi i kuadrit financiar të shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror të modeluara në kuadër të deinstitutionalizimit</b>	Mekanizmat financiarë të miratuara					
a) Hartimi dhe Kostimi i paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki.	Paketa minimale e shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen				Ka filluar procesi i hartimit të paketës minimale.	Dhjetor 2021 Dhjetor 2022
b) Hartimi dhe kostimi i modeleve të reja të shërbimit sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë	Kostimi i shërbimeve të reja të zhvilluara				Dy modele të reja të hartuara po pilotohen në Vlorë dhe Korçë	Maj 2021 Dhjetor 2021
c) Hartimi dhe kostimi i programit të ribashkimit të	Programi i hartuar dhe i kostuar i ribashkimit të				Procedura e ribashkimit është hartuar dhe po zbatohet në 6	Maj 2021



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

fëmijës me familjen	fëmijës me familjen.			bashki që kanë në territorin e tyre IPSH. Publike		
d) Hartimi i udhëzuesit për bashkitë për të planifikuar dhe aplikuar në kuadër të Fondit Social për ngritjen e shërbimeve që synojnë ribashkimin e fëmijës	Model për bashkitë për të planifikuar dhe aksesuar buxhet për shërbimet që synojnë ribashkimin e fëmijës nga Fondi Social			Udhëzuesi është duke u përgatitur.	Tetor 2021	Dhjetor 2022

Burimi: MSHMS

Nuk ka filluar (NF): Një veprim që raportohet ose vlerësohet që ende nuk ka filluar.

Në Progres (NP): Një veprim që ka filluar dhe është në vazhdim, por që ka nevojë për më shumë përpjekje për përfundimin.

Realizuar (R): Një veprim i raportuar si i përfunduar, por aty ku kërkohet një vlerësim i brendshëm ose i jashtëm për t'u konsideruar i suksesshëm.

Shënim: GTP nuk ka mbledhur të dhëna për buxhetet e alokuara dhe shpenzuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit dhe partnerët e tyre. Institucionet dhe partnerët e përfshirë ende nuk i kanë përfunduar raportet e tyre vjetore institucionale financiare. Një kolonë do shtohet, në matricën e monitorimit për secilën masë, pas mbledhjes së të dhënave financiare.<sup>4</sup>

### III. 2 Mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 - 2022

#### III. 2. 1 Mbi auditimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit në Bashkinë Vlorë

Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, MShMS ka miratuar projektin e propozuar nga Bashkia Vlorë për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe financimin e tyre nëpërmjet fondit social buxhetor. Në propozimin e dërguar nga Bashkia Vlorë me shkresën nr. 10417, datë 12.11.2020, parashikohen 3 objektiva si vijon:

1. Parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit dhe deinstitutionalizimi nëpërmjet Ri-integritit me familjet biologjike ose kujdestare;
2. Familjet dhe fëmijët përfitojnë shërbime të specializuara që adresojnë nevojat e shfaqura në aspektin e shëndetit fizik, mendor, si dhe rritja e kapaciteteve të familjeve dhe ofrimi i mundësive për tu rikuperuar gjatë fazave kur prindi nuk mund të ushtrojë përgjegjësitë e tij;

<sup>4</sup>Raport Progres e vitit 2021, për Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 ó 2022



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

3. Pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar.

Nga zbatimi i projektit dhe përmbushjes së objektivave të mësipërme, në 3 vite parashikohet të arrihen rezultatet si vijon:

**R.1** 160 familje janë mbështetur me shërbime proaktive dhe asistencë psiko-sociale, shërbime direkte duke parandaluar insitucionalizimin e fëmijëve dhe kthimin e fëmijëve në familje nga institucionet rezidenciale;

**R.285** fëmijë dhe 180 prindër kanë përfituar nga shërbime të specializuara për përmirësimin e gjendjes së tyre dhe sigurinë e një jete dinjitoze;

**R.3** 36 familje biologjike janë vlerësuar, trajnuar, mbështetur dhe supervizuar për ofrimin e një shërbimi cilësor për fëmijët;

**R.4** 160 familje janë identifikuar dhe asistuar me shërbime të integruara në familje dhe pranë institucioneve shërbim ofruese;

**R5.** 3 familje janë identifikuar, trajnuar dhe pilotojnë shërbimin e kujdesit alternativ profesional.

Nga dokumentacioni që administron MSHMS për projekt propozimin e kësaj Bashkie rezulton se, për dorëzimin e projekt propozimit, Kryetari i Bashkisë Vlorë, i është drejtuar MShMS me shkresën nr. 10417, datë 12.11.2020 dhe protokolluar në MSHMS me nr. 4716, datë 17.11.2020, nëpërmjet të cilës dërgon Planin Social të Bashkisë dhe VKB përkatëse, NIPT-in, si dhe projekt propozimin. Ndërkohë në dosjen e vënë në dispozicion, administrohet gjithashtu shkresa me nr. 10417, datë 13.11.2020, e sigluar nga Titullari i Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë BV, në emër të Kryetarit të Bashkisë, ku krahas sa më lart janë shtuar edhe dokumentet e nevojshme të partenrit (Nismës A). Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk është e qartë kujt i drejtohet shkresa e mësipërme, ajo nuk përmban vulën e institucionit, nuk është e protokolluar në MSHMS dhe përmban të njëjtin nr. protokollin me shkresën e dërguar nga titullari i BV dërguar një ditë më parë. Po kështu, nga auditimi rezulton se CD e bashkëlidhur shkresës së Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, është bosh dhe nuk përmban asnjë nga dokumentet që citohen në shkresë. Së fundmi, sa i takon projekt propozimit, në dosje gjendet dokumenti ÷Deklaratë Partneriteti÷, me anë të të cilës palët kanë shprehur vullnetin për të aplikuar si partnerë në projekt propozimin e dërguar MSHMS. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti, rezulton se ai daton më 13.11.2020 dhe mban nënshkrimin e Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë BV, në emër të Kryetarit të Bashkisë dhe nuk është i protokolluar në BV. Nga auditimi rezultoi se ky dokument nuk përfshihet në listën e dokumenteve të cituara në shkresën e Kryetarit të Bashkisë, e cila ligjërisht përmban të gjithë elementët e një shkrese zyrtare, pra konstatohet se më datë 12.11.2020 kur është dorëzuar zyrtarisht aplikimi për Fondin Social, nuk ka patur partenritet me ndonjë organizatë mbështetëse. Nga komunikimet verbale me përfaqësues të Bashkisë, rezulton se veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë kryer në kushtet e emergjencës të ndodhur në periudhën e izolimit dhe karantinimit në situatën e pandemisë, megjithatë përballë faktit se bëhet fjalë për një proces delikat siç është hyrja në marrëdhënie me palë jo publike dhe aplikimi për përdorim fondesh publike, këto veprime mbeten në kundërshtim me Normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 ÷Për miratimin e ÷rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë÷.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRMBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**Pretendimet e subjektit:** me shkresën nr. 3546/2, datë 29.04.2022, Bashkia Vlorë ka përcjellë observacionet mbi projektraportin me pretendimin se për shkak të paqartësive në hartimin dhe dërgimin e dokumentacionit zyrtar pranë MShMS, në kuadër të aplikimit për Fondin Social, Bashkia Korçë i është drejtuar MShMS me kërkesë për sqarime dhe duke marrë parasysht edhe kushtet e izolimit gjatë pandemisë, dokumentacioni është dorëzuar në dy etapa, duke plotësuar ato dokumente të cilat mungonin nga dorëzimi i parë. Ky dokumentacion është marrë në konsideratë nga MShMS, e cila e ka miratuar akordimin e fondit të kërkuar. Po kështu, lidhur me Deklaratën e Partneritetit, udhëzimet e MShMS përcaktojnë listën e dokumenteve mbështetëse për partnerët, të cilat janë dokumente shtesë të Deklaratës së partenritetit, por duke qenë se nuk kanë një format të caktuar janë hartuar nga vetë bashkia në këtë mënyrë. Po kështu edhe ky format është pranuar nga komisioni përzgjedhës për aplikimet në MShMS.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** për sa observoni më lart sqarojmë se, grupi i auditimit ka paraqitur pa rregullsitë që janë vënë re në komunikimin zyrtar mes institucioneve, sidomos kur bëhet fjalë për akordim dhe përdorim fondesh publike. Pavarësisht situatës emergjente, për rëndësinë që mbart, ky lloj dokumentacioni duhet të përmbante minimalisht vulat dhe protokollat përkatëse hyrëse dhe dalëse të institucioneve. Së dyti, referuar observacionit mbi Deklaratën e Partneritetit, sqarojmë se grupi i auditimit në asnjë rast nuk ka paraqitur konstatime mbi formatin apo përmbajtjen e deklaratës, por vetëm parregullsi në nën shkrimin e saj, pasi nisma A hyn në partneritet me Bashkinë Vlorë (përfaqësuar nga Kryetari i saj) dhe jo me një strukturë brenda Bashkisë (nënshkruar nga titullari i kësaj strukture.) Referuar kuadrit rregullator përkatës, gjurma e auditimit për procesin e mësipërm nuk është e plotë dhe bashkëlidhur sqarimeve observuese nuk janë paraqitur evidenca të reja të pa shqyrtuara më parë. Për sa më lart observacioni nuk merret parasysht.

Duke qenë se gjatë fazës së aplikimit Bashkia Vlorë dhe Nisma A kanë aplikuar si palë partnere në kuadër të kësaj thirrje, ky partenritet është konkretizuar nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 9993, datë 28.06.2021 dhe protokolluar nga Nisma A me nr. 98, datë 13.07.2021. Qëllimi i kësaj marrëveshje përcaktuar në nenin 1, është sigurimi i bashkëpunimit institucional për ngritjen dhe pilotimin e shërbimeve për mbështetjen e fëmijëve të familjeve në nevojë dhe të prindërimit pozitiv. Marrëveshja ka si objekt të saj të përcaktojë mjetet, burimet njerëzore dhe financiare, të ndajë qartazi detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe të përcaktojë mënyrat e bashkëpunimit të efektshëm midis palëve dhe lidhet për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë përtëritje.

Referuar nenit 4 të kësaj marrëveshje, Bashkia Vlorë:

- ka rolin kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit të ri të ngritur;
- siguron të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri të ngritur në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore në Bashkinë dhe Qarkun Vlorë;
- vendos në dispozicion mjediset për ofrimin e shërbimeve;
- kryen procedurat e përzgjedhjes së stafit dhe lidh kontratat e punës me to, referuar Kodit të Punës;
- paguan dhe shlyen detyrimet financiare në kohë, si dhe





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

- të rishohë dhe miratojë protokollet e shërbimit, politikat e mbrojtjes së klientëve, si dhe të gjitha dokumentat e hartuara nga Nisma A.

Ndërkohë, referuar marrëveshjes, Nisma A:

- do të mbështesë Bashkinë Vlorë në ngritjen e shërbimit, duke zhvilluar termat e referencës për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit nga ekipi i punës për deinstitutionalisimin;
- do të hartojë protokollet, procedurat dhe manualët e shërbimit përfshirë mekanizmat e ;
- do të hartojë kurikulat dhe Planin për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit nëpërmjet trajnimeve, mentorimit dhe informacionit;
- do të hartojë udhëzuesin për të gjithë profesionistët dhe institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror në Bashkinë Vlorë;
- do të ofrojë supervizimin profesional të punonjësve të shërbimit;
- do të kryejë kalimin gradual në strukturën e Bashkisë, të dy mekanizmave të mentorimit dhe supervizimit të zhvilluara dhe pilotuara nga ekipi i shoqatës Nisma A, si dhe
- do të mbështesë procesin e identifikimit të kujdestarëve profesionistë si edhe trajnimin dhe mentorimin e tyre;

Për zbatimin dhe koordinimin sa më eficient të procesit, në nenin 6 të marrëveshjes kërkohet që secila nga palët të përcaktojë një person kontakti të cilëve u drejtohet për çdo lloj komunikimi. Këta persona do të jenë përgjegjës gjithashtu për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që ka të bëjë me projektin dhe zbatimin e marrëveshjes. Nga auditimi rezultoi se në marrëveshjen e lidhur, ky nen është lënë i paplotësuar, pra nuk janë identifikuar nga asnjëra palë përfaqësuesit në cilësinë e personave të kontaktit. Për këtë detyrim, nuk është mbajtur as ndonjë doklument tjetër zyrtar për përcaktimin e tyre.

Për sa trajtuar më lart dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se, me miratimin e projekt propozimit të BV dhe financimin e tij nga fondi social, Bashkia Vlorë me VKB nr. 37, datë 27.05.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen (më tej SHMFF), përbërë prej 8 pozicioneve, në varësinë e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social. Nga auditimi rezultoi se për këtë strukturë nuk ka përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë përditësimet përkatëse në rregulloren e funksionimit. Si pasojë nuk ka qartësi dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet strukturës së SHMFF dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (më tej PMF). Referuar Rregullores së brendshme të funksionimit, struktura e PMF ka për detyrë identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe referimin e tyre, por pa u përcaktuar qartë se në cilat struktura referohet rasti. Krahas sa më lart, nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Vlorë aktualisht nuk ka një person në rolin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës.

***Pretendimet e subjektit:*** me shkresën nr. 3546/1 dhe nr. 3546/2, datë 29.04.2022, Bashkia Vlorë ka paraqitur observacionet lidhur me funksionimin e strukturave të PMF dhe ShMFF me pretendimin se përshkrimet e punë së ShMFF gjenden në termat e referencës të hartuara për këtë projekt të cilat kanë shërbyer edhe si referencë gjatë shpalljes së vendeve vakante nga Bashkia (bashkëlidhur procedurat e rekrutimit). Po kështu funksionimi i ShMFF bazohet në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, ndërsa PMF funksionon në bazë të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimet e mësipërme ri theksojmë se, së pari me ngritjen e ShMFF, struktura e Bashkisë ka pësuar ndryshim pasi i është shtuar një njësi e re dhe çdo ndryshim i tillë, duhet të pasqyrohet në Rregulloren e brendshme të funksionimit, i cili është dokumenti bazë që përcakton specifikisht detyrat, përgjegjësitë, proceset e komunikimit, linjat e varësisë dhe raportimit mes njërive të Bashkisë, etj. Çdo strukturë publike në territorin e RSh i ka fillimet nga një ligj, megjithatë proceset cituar më lart përcaktohen qartësisht në Rregulloret e brendshme të funksionimit të institucioneve që kanë pjesë përbërëse këto struktura. Krahas kësaj, në termat e referencës të hartuara nga Nisma A, thuhet në mënyrë të përgjithshme se ekipi i specialistëve (sipas secilit pozicion) do të mbështesë fëmijën dhe familjen për vlerësimin, përgatitjen apo rikthimin, si dhe do të koordinojë punën me NjMF. Pra nuk specifikohet në asnjë rast detyrat konkrete dhe hapat që duhet të ndjekë secili pozicion sipas detyrës që ka dhe nuk është e specifikuar se çfarë përfshin koordinimi mes njërive, apo protokollet se ku mbaron NjMF dhe ku fillon ShMFF. Sqarojmë për këtë rast se as protokollet e punës së ShMFF të hartuara nga Nisma A nuk janë miratuar ende nga Këshilli Bashkiak.

Për periudhën objekt auditimi struktura e ShMFF është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit dhe jo në deinstitutionalizimin e fëmijëve që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Konkretisht, që nga ngritja e saj dhe në përmbushje të rezultateve të parashikuara më lart, kjo strukturë ka patur një bashkëpunim efektiv në parandalimin e institucionalizimit dhe mbështetjen e familjeve që rrezikojnë braktisjen e fëmijës si vi vijon:

**R.1** - 69 familjeve u janë ofruar mbështetje direkte me paketa ushqimore, higjieno sanitare dhe didaktike;

- Parandalim i institucionalizimit të fëmijëve duke ofruar shërbimin e kujdesit në familje; (2 raste);

- Shoqërim i prindërve apo fëmijëve për të kryer rivlerësim të shëndetit mendor, ndryshim diagnozash nëse është vlerësuar e nevojshme dhe aplikim për përfitim të KEMP-it (3 raste);

- Asistencë dhe shoqërim i familjeve në institucione arsimore, shëndetësore, shoqërore për të përfituar nga shërbimet e nevojshme;

- Regjistrimi i fëmijëve në qendrën shëndetësore për të vijuar më tej me kontrollet rutinë dhe kalendarin e vaksinimit sipas moshës; (3 raste)

- Asistim dhe shoqërim i rasteve për të bërë regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, kopsht apo shkollë sipas nevojës; (6 raste)

- Ofrim i mbështetjes psikologjike për prindërit dhe fëmijët në mjedisin e SHMFF apo në familje; (3 raste)

- Ofrimi i asistencës për prindërit gjatë plotësimit të dokumentacionit për bonus qeraje dhe ndjekja e procedurave në vijim; (2 raste)

- Asistencë në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për përfshirjen e skemës së ndihmës ekonomike; (2 raste)

- Kryerja e vizitave në familje dhe identifikimi i nevojave; (8 raste)

- Hartimi i tre plane fuqizimi dhe monitorimi dhe dy plane kujdesi;

- Lobim në komunitet/ sigurim nga komuniteti i veshmbathjeve, mobilieve etj.

**R.228** fëmijë dhe 11 të rritur kanë përfituar nga shërbimet e SHMFF nëpërmjet punonjësit social, psikologut dhe kujdestares. Ndërkaq shërbime të tjera të specializuara nuk janë ofruar ende.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**R.3** 5 familje janë mbështetur për tu ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve më pozitive dhe kushteve më të përshtatshme të cilat kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në mirërritjen e fëmijëve.

**R.4** 69 familjeve u janë ofruar mbështetje direkte me paketa ushqimore, higjieno sanitare dhe didaktike. 28 fëmijë dhe 11 të rritur kanë përfituar nga shërbime të integruara të përmendura më sipër në R.1.

**R.5** Është bërë prezantimi i modelit të KAP dhe gjatë kësaj periudhe ka shprehur interesin për të ndjekur trajnimet e KAP vetëm një person, e cila punon si kujdestare pranë IPSH. Ndërkohë, ka nisur procesi i supervizimit profesional dhe i mentorimit për punonjësit e SHMFF, është mbështetur PMF me vlerësime në familje dhe shoqërim në terren, si dhe janë realizuar aktivitete për promovimin e shërbimit të ri dhe KAP, shpërndarje fletëpalosjesh, etj

**Pretendimet e subjektit:** Me shkresën nr. 3546/2, datë 29.04.2022 Bashkia Vlorë ka dërguar observacionet si vijon:

*Struktura e ShMFF ka ndërvepruar me PMF për rastet e fëmijëve që kanë marrë shërbime (bashkëlidhur emaile, minuta takimi dhe referime), ndërkohë ka marrë masa për përmirësimin e ambienteve të punës së ShMFF.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimet e mësipërme sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit mbi mos ndërveprimin e ShMFF dhe PMF lidhet vetëm me dy rastet e fëmijëve të institucionalizuar dhe jo në përgjithësi edhe për rastet kur është parandaluar institucionalizimi.

Deri më shkurt 2022 nuk është realizuar vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës, për arsyen sepse SHMFF nuk disponon akses në dosjet e fëmijëve rezident në IPSH, si dhe nuk janë realizuar takime individuale me këta fëmijë. Më datë 11.08.2021 ShMFF zhvilluar një takim me shërbimin psikosocial të IPSH ku është bërë një prezantim i 5 familjeve që kanë fëmijët në IPSH, por nga ShMFF nuk është marrë asnjë dokument i shkruar në dorëzim, vetëm informacioni që është referuar nga punonjëset. Kjo edhe për faktin e trajtuar më lart, të mungesës së personit referues në strukturën e bashkisë (PMF). Po kështu, sa i takon përsëri mangësive në procesin e deinstitutionalizimit, gjatë fazës së terrenit në Bashkinë Vlorë, grupi i auditimit konstatoi se në muajin dhjetor 2021, në IPSH Vlorë ishin institucionalizuar 2 fëmijë në shkelje të Moratoriumit të vendosur në VKM nr. 706, datë 09.09.2020. Për të dy rastet, ShMFF nuk kishte dijeni pasi zyrtarisht këto raste nuk i ishin referuar nga struktura përkatëse për mbrojtjen e fëmijës.

Sa i takon fuqizimit të zbatimit të kujdesit alternativ, është realizuar nga A prezantimi i modelit të Kujdestarisë Alternative Profesionale KAP me administratoret e Rajoneve, për tu njohur me modelin dhe për ta shpërndarë informacionin me qytetarë që mund të jenë të interesuar. Po kështu, është realizuar nga SHMFF prezantimi i modelit të Kujdestarisë Alternative Profesionale KAP, me prezencë të institucioneve shtetërore, organizatave e OJF. Megjithatë, ende nuk rezulton të jenë identifikuar apo ofruar familje potenciale vullnetare për aplikimin e kujdestarisë alternative.

Sa i takon zbatimit të marrëveshjes së lidhur me Nismën A, nga auditimi rezultoi se, Bashkia Vlorë në rolin e organit kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit të ri të ngritur, nuk ka garantuar të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri në sistemin aktual të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

shërbimeve shoqërore, nisur nga fakti i mos referimit të rasteve nga PMF te ShMFF, apo mos marrja e masave për propozimin e integritit të kësaj strukture në Rregulloren e brendshme të funksionimit, veprime që duhet të ishin ndërmarrë nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social. Po kështu, Bashkia nuk ka vënë në dispozicion mjediset për ofrimin e shërbimeve. Gjatë vizitave në terren u konstatua se struktura e ShMFF është akomoduar në godinën e IPSh, ku i janë vendosur në dispozicion vetëm dy ambiente të cilat kanë formën e ambienteve të magazinimit. Njëri nga ambientet përdorej pikërisht për magazinimin e bankës së ushqimit, ndërsa në ambientin tjetër qëndronin stafi i psikologëve, punonjësve social dhe kujdestareve, në mungesë të plotë të logjistikës së nevojshme. Këto dy hapësira nuk ofrojnë elementët e nevojshëm të një qendre që do të ofrojë shërbime psiko-sociale, klasa prindërimi, shërbime këshillimi, takime me palët e interesit, akses për personat AK, etj.

Së fundmi, sa i takon rishikimit dhe miratimit të protokolleve të shërbimit, politikave të mbrojtjes së klientëve, si dhe të gjitha dokumenteve të hartuara nga Nisma A, rezultoi se kjo e fundit ja ka nisur dokumentacionin e prodhuar Bashkisë Vlorë në mënyrë elektronike dhe nuk janë shoqëruar me shkresë zyrtare në protokollin e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni i hartuar nga Nisma A nuk është marrë në dorëzim nga askush dhe deri në momentin e auditimit, ato nuk janë miratuar dhe as nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë për rishikimin e tyre.

Krahas komunikimeve të vazhdueshme me përfaqësues të Bashkisë, këtyre të fundit i është kërkuar mundësi i një takimi edhe me përfaqësuesit e Nisma A, por ky takim nuk është mundësuar, në kundërshtim me nenin 3, germa b të marrëveshjes kohëzgjatja dhe disponueshmëria ku përcaktohet se Nisma A do të jetë e disponueshme përkundrejt kontrolleve audituese, çdo detyrim, monitorim apo vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm që lind nga zbatimi i marrëveshjes. Në zbatim të këtij neni të marrëveshjes grupi i auditimit fillimisht e ka kërkuar këtë gjë gjatë takimit prezantues në subjekt, me qëllim që gjatë fazës së terrenit të ishte prezent kontakti lokal i Nismës për këtë projekt në Bashkinë Vlorë. Një takim me përfaqësues të Nismës A u mundësua vetëm në fazën para përgatitjes së raportit përfundimtar, prezenca e të cilëve u shoqërua nga përfaqësues të Bashkisë Korçë, me aprovimin e titullarëve të KLSH.

Grupit të auditimit ju vunë në dispozicion minutat e takimit të Bashkisë me Nismën A, në të cilat vihen re takime të realizuara në kuadër të projektit pilot në fjalë Parandalimi i Institucionalizimit dhe Deinstotucionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit shoqërorë si dhe në kuadër të një tjetër me titull Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja, shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri dhe zbatuar në partenritet me UNICEF dhe me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, i cili ka për qëllim të ofrojë dhe sigurojë përgjigje ndaj nevojave emergjente në Shqipëri për të reduktuar pasojat e shkaktuara nga tërmetet dhe pandemi e COVID-19, në rajonet e prekura si Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasa, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë. Për sa më lart, për grupin e auditimit mbetet e pa qartë mbivendosja e çështjeve të dy projekteve pasi projekti i parë ka patur një kohëzgjatje prej 01.05.2021 ó 31.12.2021 dhe projekti i dytë ka një kohëzgjatje prej 36 muaj që fillon me nënshkrimin e marrëveshjes më datë 28.05.2021. Të dy projektet, që nga muaji maj 2021 kanë trajtuar çështje të parandalimit të institucionalizimit, por në rastin e parë Nisma vepron si nënkontraktor i UNICEF, ndërsa në rastin e dytë është përzgjedhur në mënyrë të pa qartë si



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

partner i Bashkisë, në aplikimin dhe përfitimin e fondeve nga Fondi Social i MSHMS. Edhe pas takimit ballafaques, Nisma A nuk vuri në dispozicion dokumentacion zyrtar sqarues për diferencimin mes dy projekteve, apo arsytet e mbivendosjes së tyre. Për sa më lart, për grupin e auditimit ka mungesë transparence dhe mungon gjurma e auditimit në identifikimin e projekteve me donacion apo fonde publike.

#### **Titulli i gjetjes nr. 4: Parregullsi në zyrtarizimin e komunikimeve dhe aplikimit për Fondin Social.**

**Situata:** Nga dokumentacioni që administrojnë MSHMS për projekt propozimin e kësaj Bashkie rezultojnë se, për dorëzimin e projekt propozimit, Kryetari i Bashkisë Vlorë, i është drejtuar MSHMS me shkresën nr. 10417, datë 12.11.2020 dhe protokolluar në MSHMS me nr. 4716, datë 17.11.2020, nëpërmjet të cilës dërgon Planin Social të Bashkisë dhe VKB përkatëse, NIPT-in, si dhe projekt propozimin. Ndërkohë në dosjen e vënë në dispozicion, administrohet gjithashtu shkresa me nr. 10417, datë 13.11.2020, e sigluar nga Titullari i Drejtorisë së Ndhmës dhe Shërbimit Social pranë BV, në emër të Kryetarit të Bashkisë, ku krahas sa më lart janë shtuar edhe dokumentet e nevojshme të partërisht (Nismës A). Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se nuk është e qartë kujt i drejtohet shkresa e mësipërme, ajo nuk përmban vulën e institucionit, nuk është e protokolluar në MSHMS dhe përmban të njëjtin nr. protokoll me shkresën e dërguar nga titullari i BV dërguar një ditë më parë. Po kështu, nga auditimi rezultojnë se CD e bashkëlidhur shkresës së Titullarit të Drejtorisë së Ndhmës dhe Shërbimit Social, është bosh dhe nuk përmban asnjë nga dokumentet që citohen në shkresë. Së fundmi, sa i takon projekt propozimit, në dosje gjendet dokumenti ÷Deklaratë Partneriteti, me anë të të cilës palët kanë shprehur vullnetin për të aplikuar si partnerë në projekt propozimin e dërguar MSHMS. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti, rezultojnë se ai daton më 13.11.2020 dhe mban nënshkrimin e Titullarit të Drejtorisë së Ndhmës dhe Shërbimit Social pranë BV, në emër të Kryetarit të Bashkisë dhe nuk është i protokolluar në BV. Nga auditimi rezultoi se ky dokument nuk përfshihet në listën e dokumenteve të cituara në shkresën e Kryetarit të Bashkisë, e cila ligjërisht përmban të gjithë elementët e një shkrese zyrtare, pra konstatohet se më datë 12.11.2020 kur është dorëzuar zyrtarisht aplikimi për Fondin Social, nuk ka patur partneritet me ndonjë organizatë mbështetëse.

**Kriteret:** Normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 ÷Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të republikës së Shqipërisë.

**Ndikimi/efekti:** paqartësi dhe risk për vërtetësinë e komunikimeve zyrtare.

**Shkaku:** Mos përcaktimi i qartë i roleve në aplikimin për Fondin social, si dhe mos respektimi i përcaktimeve ligjore për zyrtarizimin e komunikimeve.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Vlorë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresore zyrtare në shkëmbimet mes njërive.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

#### **Titulli i gjetjes nr. 5: Paqartësi në funksionimin e strukturave**

**Situata 1:** Me miratimin e projekt propozimit të BV dhe financimin e tij nga Fondi Social, Bashkia Vlorë me VKB nr. 37, datë 27.05.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen, përbërë prej 8 pozicionesh, në varësinë e Drejtorisë së Ndhmës dhe Shërbimit Social. Nga auditimi rezultoi se për këtë strukturë nuk ka përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë përditësimet përkatëse në rregulloren e funksionimit. Si pasojë nuk ka qartësi dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet strukturës së ShMFF dhe PMF. Referuar Rregullores së brendshme të funksionimit, struktura e PMF ka për detyrë identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe referimin e tyre, por pa u përcaktuar qartë se në cilat struktura referohet rasti. Krahas sa më lart, nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Vlorë aktualisht nuk ka një person në rolin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës.

**Kriteret 1:** VKB nr. 37, datë 27.05.2021 dhe Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Bashkisë.

**Ndikimi/efekti:** Paqartësi dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet strukturës së ShMFF dhe PMF.

**Shkaku:** Nuk kapërshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë përditësimet përkatëse në rregulloren e funksionimit.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Vlorë, të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës për secilin nga pozicionet e strukturës së ShMFF, duke përcaktuar qartë edhe dallimet dhe ndarjen e kompetencave me PMF, si dhe të përfshijë këto ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit.

#### **Titulli i gjetjes nr. 6: Mungesë progresi në procesin e deinstitutionalizimit.**

**Situata:** Për periudhën objekt auditimi struktura e ShMFF është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit dhe jo në deinstitutionalizimin e fëmijëve që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Konkretisht, që nga ngritja e saj dhe në përmbushje të rezultateve të parashikuara, kjo strukturë ka patur një bashkëpunim efektiv në parandalimin e institucionalizimit dhe mbështetjen e familjeve që rrezikojnë braktisjen. Deri më taninuk është realizuar vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës, për arsye se SHMFF nuk disponon akses në dosjet e fëmijëve rezident në IPSH, si dhe nuk janë realizuar takime individuale me këta fëmijë. Po kështu, sa i takon përsëri mangësive në procesin e deinstitutionalizimit, gjatë fazës së terrenit në Bashkinë Vlorë, grupi i auditimit konstatoi se në muajin dhjetor 2021, në IPSH Vlorë ishin institucionalizuar 2 fëmijë në shkelje të Moratoriumit të vendosur në VKM nr. 706, datë 09.09.2020. Për të dy rastet, ShMFF nuk kishte dijeni pasi zyrtarisht këto raste nuk i ishin referuar nga struktura përkatëse për mbrojtjen e fëmijës. Sa i takon fuqizimit të zbatimit të kujdesit alternativ, është realizuar nga A dhe ShMFF prezantimi i modelit të Kujdestarisë Alternative Profesionale KAP me administratoret e Rajoneve, organizatave e OJF. Megjithatë, ende nuk rezulton të jenë identifikuar apo ofruar familje potenciale vullnetare për aplikimin e kujdestarisë alternative.

**Kriteret:** VKM nr. 706, datë 09.09.2020, Plani Social i Bashkisë Vlorë dhe Projekt propozimi i Bashkisë për aplikimin për Fondin Social.

**Ndikimi/efekti:** Mos përmbushja e objektivave të përcaktuara në Planin kombëtar të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Deinstitucionalizimit.

**Shkaku:** Mungesa e angazhimeve serioze nga palët për përmbushjen e detyrimeve.

**Rëndësia:** e lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Vlorë, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social dhe ShMFF, të marrin masa për fuqizimin dhe angazhimin me seriozitet në rolin e strukturave kyçe në procesin e deinstitucionalizimit, duke analizuar shkaqet e zvarritjes së këtij procesi dhe duke hartuar plane specifike pune me veprime konkrete për zgjidhjen e këtyre pengesave, si dhe duke i mbështetur këto veprime me fushata intensive sensibilizimi për rëndësinë e këtij procesi.

#### **Titulli i gjetjes nr. 7: Mos përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes.**

**Situata:** Bashkia Vlorë në rolin e organit kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit të ri të ngritur, nuk ka garantuar të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore, nisur nga fakti i mos referimit të rasteve nga PMF te ShMFF, apo mos marrja e masave për propozimin e integrimin të kësaj strukture në Rregulloren e brendshme të funksionimit, veprime që duhet të ishin ndërmarrë nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social. Po kështu, Bashkia nuk ka vënë në dispozicion mjediset për ofrimin e shërbimeve. Gjatë vizitave në terren u konstatua se struktura e ShMFF është akomoduar në godinën e IPSH, ku i janë vendosur në dispozicion vetëm dy ambiente të cilat kanë formën e ambienteve të magazinimit. Njëri nga ambientet përdorej pikërisht për magazinimin e bankës së ushqimit, ndërsa në ambientin tjetër qëndronin stafi i psikologëve, punonjësve social dhe kujdestareve, në mungesë të plotë të logjistikës së nevojshme. Këto dy hapësira nuk ofrojnë elementët e nevojshëm të një qendre që do të ofrojë shërbime psiko-sociale, klasa prindërimi, shërbime këshillimi, takime me palët e interesit, akses për personat AK, etj. Sa i takon rishikimin dhe miratimin të protokolleve të shërbimit, politikave të mbrojtjes së klientëve, si dhe të gjitha dokumenteve të hartuara nga Nisma A, rezultoi se kjo e fundit ja ka nisur dokumentacionin e prodhuar Bashkisë Vlorë në mënyrë elektronike dhe nuk janë shoqëruar me shkresë zyrtare në protokollin e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni i hartuar nga Nisma A nuk është marrë në dorëzim nga askush dhe deri në momentin e auditimit, ato nuk janë miratuar dhe as nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë për rishikimin e tyre.

**Kriteri 1:** Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Vlorë dhe Nismës A.

**Ndikimi/efekti:** Vonesa në përmbushjen e procesit të deinstitucionalizimit.

**Shkaku:** BV nuk ka garantuar të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social të marrin masa për angazhimin me seriozitet dhe mbështetjen me të gjithë kapacitetet apo logjistikën e nevojshme në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjes. Duke qenë se në dokumentet e politikave flitet për transformim të shërbimit, këto struktura të marrin masa për gjetjen e një zgjidhje së pari sa i takon ambienteve, duke integruar brenda hapësirave të rezidencës aktuale të ISHP dhe zyrave të ShMFF, të gjitha shërbimet që parashikon mbështetja për fuqizimin e fëmijës dhe familjes.

**Rekomandimi 2:** Bashkia Vlorë të marrë masa për shqyrtimin dhe miratimin e të gjithë setit të manualeve, udhëzuesve, apo protokolleve të paraqitur nga Nisma A, duke i bërë ato të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

aplikueshme sa më parë.

#### III. 2. 2 Mbi auditimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë

Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020, MShMS ka miratuar projektin e propozuar nga Bashkia Korçë për ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe financimin e tyre nëpërmjet Fondit Social buxhetor. Në propozimin e dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën nr. 8976, datë 12.11.2020, parashikohen 3 objektiva si vijon:

4. Parandalimi i ndarjes së fëmijëve nga prindërit dhe deinstitutionalizimi nëpërmjet Ri-integrimit me familjet biologjike ose kujdestare;
5. Familjet dhe fëmijët përfitojnë shërbime të specializuara që adresojnë nevojat e shfaqura në aspektin e shëndetit fizik, mendor, si dhe rritja e kapaciteteve të familjeve dhe ofrimi i mundësive për tu rikuperuar gjatë fazave kur prindi nuk mund të ushtrojë përgjegjësitë e tij;
6. Pilotimi i kujdesit alternativ profesional për fëmijët prindërit e të cilëve nuk mund të ushtrojnë kujdes prindëror për një kohë të caktuar.

Nga zbatimi i projektit dhe përmbushja e objektivave të mësipërme parashikohet të arrihen rezultatet si vijon:

**R.1** 150 familje janë mbështetur me shërbime proaktive dhe asistencë psiko-sociale, shërbime direkte duke parandaluar insitucionalizimin e fëmijëve dhe kthimin e fëmijëve në familje nga institucionet rezidenciale;

**R.290** fëmijë dhe 160 prindër kanë përfituar nga shërbime të specializuara për përmirësimin e gjendjes së tyre dhe sigurinë e një jete dinjitoze;

**R.3** 30 familje biologjike janë vlerësuar, trajnuar, mbështetur dhe superivizuar për ofrimin e një shërbimi cilësor për fëmijët;

**R.4** 150 familje janë identifikuar dhe asistuar me shërbime të integruara në familje dhe pranë institucioneve shërbim ofruese;

**R5.** 3 familje janë identifikuar, trajnuar dhe pilotojnë shërbimin e kujdesit alternativ profesional. Duke qenë se gjatë fazës së aplikimit Bashkia Korçë dhe Nisma A kanë aplikuar si palë partnere në kuadër të kësaj thirrje, ky partneritet është konkretizuar nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 6013, datë 13.07.2021, protokolluar nga Nisma A me nr. 101, datë 15.07.2021.

Nga auditimi i minutave të takimit të zhvilluar midis Bashkisë Korçë dhe Nismës A më datë 20.05.2021 dhe 21.05.2021 u konstatua se termat e marrëveshjes së bashkëpunimit janë dakordësuar midis palëve, ku bashkia angazhohet për një rishikim final para miratimit të kësaj të kësaj të fundit në Këshillin Bashkiak. Konstatohet gjithashtu se nuk grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion procedura e dakordësimit të tekstit të marrëveshjes nga palët si edhe miratimi final i këtij teksti, i cili në vijim është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Korçë.

Nga një rishikim formal i tekstit të kësaj marrëveshje vërehet se ka një mungesë konsistence në dy elementë të këtij dokumenti: numri i faqeve dhe aneksi bashkëlidhur marrëveshjes. Lidhur me elementin e parë konstatohet se kjo marrëveshje duhet të përmbajë 8 faqe (nisur nga fakti se faqja e parë e saj është emërtuar 1 nga 8), ndërkohë që rezulton se, pas faqes 8 nga 8 vijohet me





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

faqen 8 nga 9 dhe përsëri 8 nga 8 e 8 nga 9 (pra është shtuar një faqe dhe këto dy faqe përsëriten). Marrëveshja mbyllet me firmat e palëve dhe faqja është pa numër, ndërkohë që firmat e palëve gjenden edhe në faqen 7 nga 8. Lidhur me elementin e dytë, konstatohet se - referuar nenit 10, pika vi) Dispozita të Funditë ku thuhet se pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe Aneksi 1 Tabela me zërat e buxhetit - faqet në vijim 8 nga 8 dhe 8 nga 9 nuk kanë emërtimin Aneksi 1 sikundër kërkohet nga vet marrëveshja. Konstatimet sa më lart evidentojnë faktin se një dokument i tillë mund të jetë lehtësisht i manipulueshëm.

Qëllimi i kësaj marrëveshje përcaktuar në nenin 1, është sigurimi i bashkëpunimit institucional për ngritjen dhe pilotimin e shërbimeve për mbështetjen e fëmijëve të familjeve në nevojë dhe të prindërimit pozitiv. Marrëveshja ka si objekt të saj të përcaktojë mjetet, burimet njerëzore dhe financiare, të ndajë qartazi detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe të përcaktojë mënyrat e bashkëpunimit të efektshëm midis palëve dhe lidhet për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë përtëritje.

Referuar nenit 4 të kësaj marrëveshje, Bashkia Korçë:

- ka rolin kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit të ri të ngritur;
- siguron të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri të ngritur në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore në Bashkinë dhe Qarkun Korçë;
- vendos në dispozicion mjediset për ofrimin e shërbimeve;
- kryen procedurat e përzgjedhjes së stafit dhe lidh kontratat e punës me to, referuar Kodit të Punës;
- paguan dhe shlyen detyrimet financiare në kohë, si dhe
- të rishohë dhe miratojë protokollat e shërbimit, politikat e mbrojtjes së klientëve, si dhe të gjitha dokumentat e hartuara nga Nisma A.

Ndërkohë, referuar marrëveshjes, Nisma A:

- do të mbështesë Bashkinë Vlorë në ngritjen e shërbimit, duke zhvilluar termat e referencës për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit nga ekipi i punës për deinstitutionalisimin;
- do të hartojë protokollat, procedurat dhe manualët e shërbimit përfshirë mekanizmat e ;
- do të hartojë kurikulat dhe Planin për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit nëpërmjet trajnimeve, mentorimit dhe informacionit;
- do të hartojë udhëzuesin për të gjithë profesionistët dhe institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror në Bashkinë Vlorë;
- do të ofrojë supervizimin profesional të punonjësve të shërbimit;
- do të kryejë kalimin gradual në strukturën e Bashkisë, të dy mekanizmave të mentorimit dhe supervizimit të zhvilluara dhe pilotuara nga ekipi i shoqatës NISMA A, si dhe
- do të mbështesë procesin e identifikimit të kujdestarëve profesionistë si edhe trajnimin dhe mentorimin e tyre;

Për zbatimin dhe koordinimin sa më eficient të procesit, në nenin 6 të marrëveshjes kërkohet që secila nga palët të përcaktojë një person kontakti të cilit u drejtohet për çdo lloj komunikimi. Këta persona do të jenë përgjegjës gjithashtu për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që ka të bëjë me projektin dhe zbatimin e marrëveshjes. Në kundërshtim me nenin 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit nënshkruar nga palët nuk është përcaktuar personi i kontaktit për të koordinuar me Nismën A, si nga ana e Bashkisë, ashtu edhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

nga ana e Nismës, duke krijuar problematika pikërisht në përgjegjësitë për saktësimin e protokolleve, procesverbaleve, listave dhe çdo dokumenti tjetër që do të prodhohet në kuadër të zbatimit të marrëveshjes.

Komunikimet midis Nisma A dhe Bashkisë Korçë nuk janë realizuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet përcjelljes së materialeve të prodhuara nga A për shërbimin mbështetës për fëmijën dhe familjen, por kanë qenë komunikime elektronike jo zyrtare.

Me nënshkrimin e marrëveshjes palët kanë rënë dakord edhe për burimet financiare dhe njerëzore siç edhe specifikohet në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje. Më konkretisht fondi limit për realizimin e detyrave për periudhën e zbatimit të saj është 2,767,000 lekë për shërbimet e mëposhtme:

- trajnime të stafit, 350,000 lekë
- mentorimi i punonjësve të shërbimit, 180,000 lekë
- supervizimi i punonjësve të shërbimit, 126,000 lekë
- hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit, 325,000 lekë
- trajnimi i kujdestarëve alternativë profesionalë, 450,000 lekë
- mentorimi i kujdestarëve alternativë profesionalë, 180,000 lekë
- supervizimi i kujdestarëve alternativë profesionalë, 336,000 lekë
- menaxhim i shërbimit (me kohë të pjesshme), oficer finance (me kohë të pjesshme); logjist/shofer (me kohë të pjesshme), 820,000 lekë.

Në këtë nen parashikohet që pagesat të kryen nga Bashkia Korçë, pas verifikimit dhe miratimit të të gjitha detyrave/dokumenteve të rëna dakord, për secilin nga produktet. Ndërkohë që Nisma A do të vërë në dispozicion stafin ku përfshihen: ekspertë, psikologë dhe punonjës social, team leader dhe një supervizor i shërbimit psilokogjik, ekspert financiar, ekspert ligjore si dhe një punonjës vendor me kohë të plotë pranë institucionit përkatës të shtëpisë së foshnjës Korçë. Për çdo shërbim të kryer Nisma do të lëshojë faturë tatimore. Nga auditimi është konstatuar se nga ana e Bashkisë Korçë nuk ka pasur verifikim dhe/ose miratim të të gjitha detyrave/dokumenteve të prodhuara nga Nisma në kuadër të zbatimit të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu konstatohet se Nisma A ka vendosur një punonjës vendor me kohë të plotë, i cili nuk është i vendosur pranë IPSH ó së òLulet e Voglaö.

Për sa parashikuar më lart dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se:

Me miratimin e projekt propozimit të BK dhe financimin e tij nga Fondi Social, Bashkia Korçë me VKB nr. 59, datë 03.06.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen (më tej SHMFF), përbërë prej 8 pozicioneve në varësinë e Drejtorisë së Kujdesit Social. Nga auditimi ka rezultuar se për këtë strukturë nuk ka ende përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë ndryshimet përkatëse në rregullore. Si pasojë e kësaj nuk ka ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet SHMFF dhe PMF (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës). Bashkia Korçë zyrtarisht është përgjegjës për rregullorja është në proces rishikimi dhe se po bashkëpunohet me Nismën A për hartimin e përshkrimeve të punës.

Sa i takon aplikimit të Bashkisë Korçë për përfitim të fondeve nga fondi social është konstatuar se deklarata e partneritetit paraqitur së bashku me këtë aplikim me nr. 8975, prot., datë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

13.11.2020 është nënshkruar nga Bashkia Korçë (në mungesë dhe me porosi znj. B.TH.), ndërsa në vendin e nënshkrimit dhe vulosjes së këtij dokumenti nga ana e Nsimës A firma e Drejtorit Ekzekutiv së bashku me vulën janë të skanuara dhe jo origjinale, Deklarata nuk është nënshkruar njëkohësisht nga të dyja palët, në kundërshtim me normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 për miratimin e urregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të republikës së Shqipërisë. Gjithashtu bashkëlidhur aplikimit është vendosur CD i aplikimit i cili është bosh.

Për periudhën objekt auditimi, SHMFF është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit e jo në deinstitutionalim të fëmijëve rezidentë në IPSH Korçë. Aktualisht nga fëmijët rezidentë në këtë institucion gjendja paraqitet si vijon:

Nr.	Emër/Mbiemër	Datëlindja	Vendlindja	Ne proces birësimi	Te birësuar	Kthim ne familjen biologjike	mosha 3-6 vjeç	Largimet / Transferimet
				7	8	9		10
1	D.T	17.11.2015	Tirane			jo	6 vjeç e 2 muaj	duhet të ish larguar
2	A. S	28.08.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 5 muaj	për 7 muaj largohet
3	I. Sh	04.09.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 4 muaj	për 6 muaj largohet
4	E.Ç	06.09.2020	Pogradec	x			në proces birësimi	<b>në proces birësimi</b>
5	A.K	02.10.2016	Korçë	x			5 vjeç e 3 muaj	<b>në proces birësimi</b>
6	S. K	28.10.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 3 muaj	për 9 muaj largohet
7	A. T	13.11.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 2 muaj	për 10 muaj largohet
8	E. S	25.11.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 2 muaj	për 10 muaj largohet
9	S.D	18.06.2016	Korçë			jo	5 vjeç e 7 muaj	për 5 muaj largohet
10	S. K	31.08.2018	Korçë	x			3 vjeç e 5 muaj	<b>në proces birësimi</b>
11	J.K	03.03.2019	Korçë			jo	2 vjeç e 10 muaj	për 3 vjet e 2 muaj largohet
12	M.Sh	13.01.2017	Bilisht			jo	5 vjeç	për 11 muaj largohet
13	K. Sh	03.07.2018	Bilisht			jo	3 vjeç e 6 muaj	për 2 vjet e 6 muaj largohet

Burimi: IPSH Korçë

Sikurse shihet edhe më sipër, shërbim i ri i krijuar nuk ka nisur punën me fëmijët e institucionalizuar për të fuqizuar familjen dhe për të pozicionuar këta fëmijë në familje



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

kujdestare profesionale apo familje me ligje gjaku. Gjithashtu, deinstitutionalizimi në IPSH Korçë do të funksionojë vetëm në drejtim të largimit të fëmijëve aktualisht rezident në institucione të tjera rezidenciale dhe për efekte birësimi e jo për arsye të kthimit të këtyre fëmijëve në familjet e tyre biologjike. Nga 13 fëmijë aktualisht rezidentë, 2 janë në proces birësimi, 1 fëmijë duhet të ishte transferuar në një IPSH tjetër për shkak të mbushjes së moshës, 7 fëmijë do të largohen nga institucioni në institucione të tjera rezidenciale brenda maksimumi 11 muajve të ardhshëm për shkak se gradualisht mbushin moshën për tu transferuar. Si rrjedhojë, në IPSH Korçë mbeten vetëm 2 fëmijë rezidentë të cilët janë ende larg mbushje së moshës për tu transferuar edhe ata në IPSH të tjera. Për sa më lart nuk rezulton të jetë përmbushur procesi i deinstitutionalizimit në Bashkinë Korçë dhe as ai i transformimit të shërbimeve të ofruara nga IPSH në diçka tjetër, për aq kohë sa këta fëmijë do të jenë përsëri objekt i politikave të deinstitutionalizimit në institucionet rezidenciale ku do të shkojnë.

Deri në momentin e kryerjes së këtij auditimi, nga ana e pushtetit vendor dhe atij qendror nuk janë hartuar ende plane për transformimin e Shtëpisë së Foshnjës Korçë si institucion dhe si shërbim.

Për periudhën objekt auditimi SHMFF ka raportuar sa më poshtë:

- janë vlerësuar nëntë fëmijë dhe familjet biologjike të cilët janë institucionalizuar pas fazës së parë të vlerësimit<sup>5</sup> dhe janë rivlerësuar familjet e fëmijëve të cilët janë vlerësuar gjatë fazës së parë.
- është bërë vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe janë hartuar planet individuale të zhvillimit. Për dy prej tyre nuk janë hartuar plane pasi për një prej fëmijëve institucioni kishte nisur procesin e transferimit në një qendër tjetër rezidenciale jopublike dhe një prej fëmijëve ka qenë në proces birësimi. Pas vlerësimit kanë rezultuar se për tre nga fëmijët pas hartimit të planeve të fuqizimit drejt ribashkimit me familjet biologjike pas zbatimit të hapave të tyre fëmijët janë bashkuar më familjet. Familjet e fëmijëve të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror janë mbështetur me ndihmë materiale si edhe një familje është mbështetur me shërbimit të kujdesit në shtëpi.
- është prandaluar instucionalizimi i një fëmijë të braktisur në Shtëpinë e Lindjes Ersekë duke u vendosur në familje kujdestare vullnetare pa lidhje gjaku. Për rastin e një fëmije të institucionalizuar në IPSH Korçë është në proces vlerësimi gjyshja e fëmijës si familje potenciale kujdestare me lidhje gjaku në interesin më të lartë të fëmijës për të parandaluar dhe transferimin në institucion tjetër rezidencial.
- janë realizuar 15 ditë trajnime për 58 administratorët e ndihmës ekonomike dhe shoqërore në bashkinë Korçë për ushtrimin e funksioneve të shërbimeve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në muajt shtator dhe tetor 2021. Punonjësit e rinj të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen janë trajnuar, mentoruar dhe supervizuar për mundësimin e parandalimit të institucionizimit dhe mundësimin e deinstitutionalizimit. Gjithashtu është në vijim mentorimi

<sup>5</sup>Faza e parë e vlerësimit është kryer në kontekstin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë, DRSHSSH Korçë, Shtëpisë së Foshnjës dhe Nisma për ndryshim shoqëror ARSIS (nr. 420, prot. të Bashkisë Korçë, datë 18.01.2019).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

dhe supervizimi i strukturavetë bashkisë Korçë për sigurimin e mirëqenies së qytetarëve që jetojnë në territor.

- janë realizuar takime me temë òRibashkimi i fëmijës me familjen, progresi dhe mundësitë për zhvillim dhe parandalimi i ndarjes, Konferenca Kombëtare òProcesi i Deinstitutionalizimit në Shqipëri, Arritjet, Sfidat dhe Vizioni për të Ardhmenò. Bashkia Korçë ka realizuar një takim me aktorët e Grupit të Dialogut Social, i cili është ngritur në zbatim të planit Social të Bashkisë ku është prezantuar modeli i kujdestarisë alternative profesionale. Gjatë këtyre viteve bashkia gjithashtu në bashkëpunim me organizata të ndryshme, si Bethany, Fshatrat SOS dhe NISMA A, ka relalizuar takime të ndryshme me grupe interesi për kujdestarinë alternative. Në nëntor të 2021 në kuadër të ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, e drejta e fëmijës për të jetuar në një mjedis familjar me moton: òFamilja jote, rruga për tek familja imeò ka nisur një fushatë ndërgjegjësuese, e cila do të shtrihet në një afat kohor të gjatë për identifikimin e familjeve potenciale kujdestare alternative.

- janë ngritur Skuadrat Vendore Koordinuese dhe janë realizuar 8 takime në të cilat janë diskutuar, draft planet e fuqizimit drejt ri-bashkimit të familjeve të fëmijëve të institucionailizuar IPSH Korçë, ndarja dhe diskutimi për detyrat që caktohen nga Urdhëri i Ministrisë MSHMS nr.548, datë 01.10.2020 òPër ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 - 2022, diskutimin rreth planeve të fuqizimit të hartuara dhe ndërmarrja e hapave të mëtejshëm për rastet dhe ndarja e informacionit mbi ecurinë e punës me familjet e fëmijëve të akomoduar në Shtëpinë e Foshnjës òLulet e Voglaò, Korçë mes grupit të koordinimit vendor. Gjithashtu janë realizuar dhe dy takime të Komitetit Drejtues dhe Komitetit dhe Grupit Teknik.

- realizuar një raport progresi i vitit 2020 për Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit të viti 2020 - 2022 dhe është në proces hartimi plani progresi i viti 2021 i cili përfund në janar të vitit 2022.

Referuar objektivave të vendosura nga vet Bashkia në aplikimin për fondin social rezulton se asnjë nga arritjet e SHMFF Korçë nuk është në linjë me këto objektiva:

Krahas komunikimeve të vazhdueshme me përfaqësues të Bashkisë, këtyre të fundit i është kërkuar mundësimi i një takimi edhe me përfaqësuesit e Nisma A, por ky takim nuk është mundësuar, në kundërshtim me nenin 3, germa b të marrëveshjes òKohëzgjatja dhe disponueshmëriaò ku përcaktohet se òNisma A do të jetë e disponueshme përkundrejt kontrolleve audituese, çdo detyrim, monitorim apo vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm që lind nga zbatimi i marrëveshjes.ò Në zbatim të këtij neni të marrëveshjes grupi i auditimit fillimisht e ka kërkuar këtë gjë gjatë takimit prezantues në subjekt, me qëllim që gjatë fazës së terrenit të ishte prezent kontakti lokal i Nismës për këtë projekt në Bashkinë Korçë.

Grupit të auditimit ju vunë në dispozicion minutat e takimit të Bashkisë me Nismën A, në të cilat vihen re takime të realizuara në kuadër të projektit pilot në fjalë òParandalimi i Institutionalizimit dhe Deinstitutionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit shoqërorò si dhe në kuadër të një tjetër me titull òPërgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit të fëmijëve dhe ndarjes nga familja, shkaktuar nga emergjencat në Shqipëri dhe zbatuar në partenritet me UNICEF dhe me mbështetjen e Qeverisë Suedezeò, i cili ka për qëllim të ofrojë dhe sigurojë përgjigje ndaj nevojave emergjente në Shqipëri për të reduktuar pasojat e shkaktuara nga



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

tërmetet dhe pandemi e COVID-19, në rajonet e prekura si Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Kukës, Korçë dhe Vlorë. Për sa më lart dhe në mungesë të takimit me përfaqësues të A, për grupin e auditimit mbetet e pa qartë mbivendosja e çështjeve të dy projekteve pasi projekti i parë ka një kohëzgjatje prej 01.05.2021 ó 31.12.2021 dhe projekti i dytë ka një kohëzgjatje prej 36 muaj që fillon me nënshkrimin e marrëveshjes më datë 28.05.2021. Të dy projektet, që nga muaji maj 2021 kanë trajtuar çështje të parandalimit të institucionalizimit, por në rastin e parë Nisma vepron si nënkontraktor i UNICEF, ndërsa në rastin e dytë është përzgjedhur në mënyrë të pa qartë si partner i Bashkisë, në aplikimin dhe përfitimin e fondeve nga Fondi Social i MSHMS.

*Lidhur me sa më sipër OJF – partner lokal i Bashkisë Korçë ka paraqitur observacionet dërguar me shkresën nr. 55, prot., date 29.04.2022, protokolluar me tonën me shkresë nr. 1267/18, prot., datë 04.05.2021 ku shprehet se:*

#### ***Pretendimet e Subjektit:***

- 1. Lidhur me kërkesën e grupit të auditimit për tu takuar me partnerin lokal në Bashkinë Korçë, Nisma sqaron se në asnjë moment gjatë zbatimit të marrëveshjes nuk i është shmangur përgjegjësi dhe ka qenë në pritje të një komunikimi për takim nga grupi i auditimit apo qoftë edhe nga subjektet e tjera të përfshira në këtë auditim. Në datat 17.01.2022 – 21.01.2022 asnjë nga stafi i Nismës nuk ka qenë me Covid.*
- 2. Lidhur me gjetjen nr. 10, Nisma ka komunikuar me Bashkinë Korçë nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta në formë elektronike për shkak të pandemisë Covid.*
- 3. Nisma ka patur të kontraktuar punonjës vendor me kohë të plotë znj. Sh. deri më gusht 2021, e më vonë me kalimin e saj si koordinatorë e SHMFF pranë Bashkisë Korçë është vendosur z. K.B.. IPSH nuk ka pasur mundësi për vendosjen e punonjësit vendor në godinën e IPSH për shkak të pandemisë por drejtuesit e institucionit kanë qenë vazhdimisht në kontakt me të.*

#### ***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

- 1. Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se nuk është detyrë e grupit të auditimit të kontaktojë me subjekte të treta (private) që nuk janë dhe nuk mund të jenë subjekte auditimi, por është detyrë e institucioneve që kanë lidhje me to, sikundër ishte në rastin e OJF – së në fjalë, nisur nga fakti se marrëveshja e nënshkruar me Bashkinë Korçë garanton shqyrtimin nga auditimi. Fakti që institucionet Bashkia Korçë dhe Bashkia Vlorë nuk kanë njoftuar duke mos mundësuar takimin e OJF – në nuk ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit.*
- 2. Konstatimi lidhet me detyrimin e Bashkisë Korçë të mbajë komunikime shkresore me subjektet me të cilat bashkëpunon.*
- 3. Lidhur me sa më sipër, sqarojmë se ende nuk respektohet kërkesa e marrëveshjes midis Bashkisë Korçë dhe Nismës për vendosjen e punonjësit vendor me kohë të plotë pranë IPSH “Lulet e Vogla”, si dhe drejtuesi i këtij institucioni nuk është në dijeni se kush është personi që ka zëvendësuar znj. Sh. në këtë detyrë. Sqarojmë gjithashtu se nuk është detyrë e Nismës sistemimi i punonjësit vendor pranë IPSH, si dhe çdo pasojë tjetër që rrjedh nga kjo gjë.*

*Lidhur me sa më sipër Bashkia Korçë ka paraqitur observacionin nr. 3/6 prot., datë 27.04.2022, protokolluar me tonën nr. 1267/16, datë 04.05.2022.*

#### ***Pretendimet e subjektit:***



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*Gjetja nr. 10, Rekomandimi nr. 1: Duke qenë se marrëveshja është nënshkruar nga titullari i partnerit dhe kryetari i Bashkisë personat e kontaktit janë këta të dy dhe mund të delegojnë ose jo të drejtën e tyre.*

*Gjithashtu përcaktimi i personit me kohë të plotë pranë shtëpisë së foshnjës “Lulet e Vogla” është objekt i marrëveshjes së mëparshme midis Bashkisë Korçë, Nisma A, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Shtëpisë së Foshnjës, e për këtë deri në 31.12.2021 ka qenë znj. M.Sh. dhe më pas është vendosur z. K.B. me kalimin e znj. Sh. si përgjegjëse e sektorit të SHMFF.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Lidhur me pretendimin e parë observacioni nuk pranohet pasi nuk është vendosur personi i kontaktit në marrëveshje dhe vendi është lenë bosh, si dhe nuk është vendosur në dispozicion delegim i kësaj detyre.*

*Lidhur me pretendimin e dytë observacioni nuk pranohet pasi citimi i grupit të auditimit i referohet pikërisht marrëveshjes aktuale midis Bashkisë dhe Nismës në nenin 5, paragrafët ii) dhe iii). Gjithashtu rezulton nga dokumentacioni i paraqitur nga Nisma që znj. Sh. ka qenë person i punësuar me kohë të plotë pranë Shtëpisë së Foshnjës deri më Gusht 2021 e jo deri më dhjetor 2021, e më vonë në shtator 2021 është caktuar z. B..*

#### **Titulli i gjetjes nr. 8: Parregullsi në zyrtarizimin e komunikimeve dhe aplikimit për Fondin Social.**

**Situata:** Nga auditimi i minutave të takimit të zhvilluar midis Bashkisë Korçë dhe Nismës A më datë 20.05.2021 dhe 21.05.2021 u konstatua se termat e marrëveshjes së bashkëpunimit janë dakordësuar midis palëve, ku bashkia angazhohet për një rishikim final para miratimit të kësaj të kësaj të fundit në Këshillin Bashkiak. Konstatohet gjithashtu se nuk grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion procedura e dakordësimit të tekstit të marrëveshjes nga palët si edhe miratimi final i këtij teksti, i cili në vijim është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Korçë. Nga një rishikim formal i tekstit të kësaj marrëveshje vërehet se ka një mungesë konsistence në dy elementë të këtij dokumenti: numri i faqeve dhe aneksi bashkëlidhur marrëveshjes. Lidhur me elementin e parë konstatohet se kjo marrëveshje duhet të përmbajë 8 faqe (nisur nga fakti se faqja e parë e saj është emërtuar 1 nga 8), ndërkohë që rezulton se, pas faqes 8 nga 8 vijohet me faqen 8 nga 9 dhe përsëri 8 nga 8 e 8 nga 9 (pra është shtuar një faqe dhe këto dy faqe përsëriten). Marrëveshja mbyllet me firmat e palëve dhe faqja është pa numër, ndërkohë që firmat e palëve gjenden edhe në faqen 7 nga 8. Lidhur me elementin e dytë, konstatohet se - referuar nenit 10, pika vi) dispozita të Funditë ku thuhet se pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe Aneksi 1 Tabela me zërat e buxhetit - faqet në vijim 8 nga 8 dhe 8 nga 9 nuk kanë emërtimin Aneksi 1 sikundër kërkohet nga vet marrëveshja. Konstatimet sa më lart evidentojnë faktin se një dokument i tillë mund të jetë lehtësisht i manipulueshëm.

Sa i takon aplikimit të Bashkisë Korçë për përfitimin e fondeve nga fondi social është konstatuar se deklarata e partneritetit paraqitur së bashku me këtë aplikim me nr. 8975, prot., datë 13.11.2020 është nënshkruar nga Bashkia Korçë (në mungesë dhe me porosi znj. B.TH.), ndërsa në vendin e nënshkrimit dhe vulosjes së këtij dokumenti nga ana e Nismës A firma e Drejtorit Ekzekutiv së bashku me vulën janë të skanuara dhe jo origjinale, Deklarata nuk është nënshkruar njëkohësisht nga të dyja palët, në kundërshtim me normat tekniko - profesionale dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 òPër miratimin e òrregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu bashkëlidhur aplikimit është vendosur CD i aplikimit i cili është bosh.

**Kriteret:** Normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 òPër miratimin e òrregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të republikës së Shqipërisë.

**Ndikimi/efekti:** paqartësi dhe risk për vërtetësinë e komunikimeve zyrtare.

**Shkaku:** Mos përcaktimi i qartë i roleve në aplikimin për Fondin social, si dhe mos respektimi i përcaktimeve ligjore për zyrtarizimin e komunikimeve.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Korçë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresore zyrtare në shkëmbimet mes njëjseve.

#### Titulli i gjetjes nr. 9: Paqartësi në funksionimin e strukturave

**Situata:** Me miratimin e projekt propozimit të BK dhe financimin e tij nga Fondi Social, Bashkia Korçë me VKB nr. 59, datë 03.06.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen (më tej SHMFF), përbërë prej 8 pozicioneve në varësinë e Drejtorisë së Kujdesit Social. Nga auditimi ka rezultuar se për këtë strukturë nuk ka ende përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë ndryshimet përkatëse në rregullore. Si pasojë e kësaj nuk ka ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet SHMFF dhe PMF (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës). Bashkia Korçë zyrtarisht është përgjigjur se rregullorja është në proces rishikimi dhe se po bashkëpunohet me Nismën A për hartimin e përshkrimeve të punës.

**Kriteret:** VKB nr. 59, datë 03.06.2021 Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Bashkisë.

**Ndikimi/efekti:** Paqartësi dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet strukturës së SHMFF dhe PMF.

**Shkaku:** Nuk kapërshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë përditësimet përkatëse në rregulloren e funksionimit.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Korçë të marrë masa të menjëhershme për të reflektuar sa më shpejt termat e referencës së SHMFF në Rregulloren e Brendshme pasi ato të kenë marrë miratimet përkatëse për këtë qëllim.

**Menjëherë**

#### Titulli i gjetjes nr. 10: Mos përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes.

**Situata:** Në kundërshtim me nenin 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit nënshkruar nga palët nuk është përcaktuar personi i kontaktit për të koordinuar me Nismën A, si nga ana e Bashkisë Korçë, ashtu edhe nga ana e Nismës, duke krijuar problematika pikërisht në përgjegjësitë për saktësimin e protokolleve, procesverbaleve, listave dhe çdo dokumenti tjetër që do të prodhohet në kuadër të zbatimit të marrëveshjes. Komunikimet midis Nisma A dhe Bashkisë Korçë nuk janë realizuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet përcjelljes së materialeve të prodhuara nga A për shërbimin





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

mbështetës për fëmijën dhe familjen, por kanë qenë komunikime elektronike jo zyrtare. Nga auditimi është konstatuar se nga ana e Bashkisë Korçë nuk ka pasur verifikim dhe/ose miratim të të gjitha detyrave/dokumenteve të prodhuara nga Nisma në kuadër të zbatimit të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu konstatohet se Nisma A ka vendosur një punonjës vendor me kohë të plotë, i cili nuk është i vendosur pranë IPSH ó së òLulet e Voglaò.

**Kriteri 2:** Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Korçë dhe Nismës A

**Ndikimi/efekti:** Vonesa në përmbushjen e procesit të deinstitutionalizimit.

**Shkaku:** BV nuk ka garantuar të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi 1:** Bashkia Korçë të marrë masat për zyrtarizmin e komunikimeve me partnerin e projektit, duke përcaktuar personin e kontaktit për bashkinë dhe duke kërkuar nga NISMA përcaktimin zyrtar të personit të kontaktit, si dhe duke proceduar me miratimet dhe diskutimet përkatëse për çdo dokument të prodhuar nga partneri në përfitim të bashkisë.

*Menjëherë*

### III. 3 Mbi auditimin e shpenzimeve të kryera në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020 – 2022

#### III. 3. 1 Aplikimi për fondin social në zbatim të planit kombëtar të deinstitutionalizimit

Vlerësimi i dosjeve për dy bashkitë pilot

##### **a) Bashkia Korçë:**

Për vitin 2021, në Bashkinë e Korçës për Qendrën e Shërbimeve Mbështetëse, llogaria 606 janë parashikuar 11,814,740 lekë nga të cilat janë realizuar 4,313,455 lekë. Konkretisht, nga Bashkia e Korçës është aplikuar për fondin social si më poshtë:

Vitet	Kostoja totale	Shuma e kërkuar për Fondin Social	% e fondit të kërkuar	Kostoja që mbulohet nga kontributi I bashkisë dhe partnerët
Viti 2021	13,094,740	11,814,740	90%	24,909,480
Viti 2022	13,117,740	7,909,118	60%	21,026,858
Viti 2023	13,117,740	3,946,724	30%	17,064,464
Total	39,330,220	23,670,582	60%	15,659,638

*Tabela 1: Kërkesa për fonde/ Burimi: MSHMS*

Në dosje gjendet dokumentacioni i projekt propozimit për programin e Fondit Social për Shërbime me bazë komunitare, nga MSHMS. Konkretisht Bashkia Korçë me shkresën nr.8976 datë 13.11.2020 është dorëzuar dokumentacioni:

Dokument zyrtar që tregon NIPT-i i Bashkisë Korçë, Plani Social, Dokumentet mbështetëse që tregojnë kapacitetin e BK në lidhje me bashkimin e projektit, formulari i aplikimit, deklarata e partneritetit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Në dosjen e aplikimit të Bashkisë Korçë, gjendet marrëveshja e mëparshme e A dhe Bashkisë Korçë me nr.420 datë 18.01.2019 e cila ka përfunduar brenda datës 30.10.2019. Plani i punës në dosjen e aplikimit përfshin 5 objektiva dhe 9 aktivitete për të realizuar, dhe është përcaktuar buxhet plani për shpenzimet ÷Pagat e punonjësve social, psikologëve, kujdestarëve si edhe kostot e shërbimeve direkte dhe të logjistikës së respektivisht për 3 vite: 19,840,000 lekë, 4,650,000 lekë dhe 4,100,000 lekë, 1,500,000 lekë, 2,744,220 lekë dhe 5,440,000 lekë si dhe ÷Kosto e tarifave administrative dhe pagat e punonjësve të shërbimito 1,500,000 lekë por nuk është detajuar buxheti për shpenzimet që do të realizohen për shpenzimet.

Nga auditimi u konstatua se dokumenti i partneritetit që mban dosja e aplikimit me nr.8975 datë 13.11.2020, nuk është dokument origjinal. Kjo pasi edhe pse firma dhe vula e institucionit të bashkisë është origjinale, vula dhe firma e Nismës A është e skanuar. Nisur nga kjo mund të themi se në dosjen e aplikimit nuk ka një dokument zyrtar që vërteton partneritetin e Bashkisë Korçë dhe Nisma A, ose bashkëpunimin e A me UNICEF në kuadër të de institucionalizimit.

#### **b) Bashkia Vlorë:**

Për vitin 2021, është bërë transferimi i fondeve me shkresën nr.630/26 datë 09.04.2021 për Bashkinë Vlorë në vlerën 11,682,740 lekë. Në Bashkinë e Vlorës për Qendrën e Shërbimeve mbështetëse, llogaria 606 janë parashikuar 11,682,740 lekë nga të cilat janë realizuar 4,804,914 lekë. Konkretisht, nga bashkia e Vlorës është aplikuar për fondin social si më poshtë:

Vitet	Kostoja totale	Shuma e kërkuar për Fondin Social	% e fondit të kërkuar	Kostoja që mbulohet nga kontributi I bashkisë dhe partnerët
Viti 2021	12,986,740	11,682,740	90%	1,304,000
Viti 2022	13,304,740	8,018,188	60%	5,286,552
Viti 2023	13,329,740	3,971,724	30%	9,358,016
Total	39,621,220	23,672,652	60%	15,948,568

*Tabela 2: Kërkesa për fonde/ Burimi: MSHMS*

Nga auditimi i dosjeve të aplikimit rezultoi se dosja përmbante: dokumentet e projekt propozimit dërguar me shkresën nr.10417 datë 12.11.2020 si: Planin social BV, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.37 datë 27.05.2021 për ngritjen e shërbimit mbështetës për fëmijët dhe familjen në kuadër të transformimit të shërbimeve rezidenciale në shërbime me bazë komunitare dhe Projekt Propozimi Aneksi 1.Plani i punës në dosjen e aplikimit përfshin 5 objektiva dhe përfshinë 9 aktivitete për të realizuar, për të cilat e vetmja kosto e përlogaritur është përshkrimi i buxhetit: ÷Pagat e punonjësve social, psikologëve, kujdestarëve si edhe kostot e shërbimeve direkte dhe të logjistikës së respektivisht për 3 vite: 19,840,000 lekë, 4,500,000 lekë dhe 4,200,000 lekë, 1,500,000 lekë, 2,770,000 lekë dhe 5,266,000 lekë si dhe ÷Kosto e tarifave administrative dhe pagat e punonjësve të shërbimito 1,500,000 lekë por nuk është detajuar buxheti për shpenzimet që do të realizohen për shpenzimet. Gjithashtu në dosjen e aplikimit u konstatua dhe një shkresë për dërgimin e dokumenteve të projekt propozimit me të njëjtin numër protokoll si shkresa



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

nr.10417 por me datë 13.11.2021 në të cilën citohet se bashkëlidhur përveç dokumenteve të mësipërme gjendet edhe deklarata e partneritetit midis Bashkisë Vlorë dhe Nisma A. Kjo shkresë nuk është as e firmosur nga Kryetari i Bashkisë dhe as e vulosur. Deklarata e partneritetit e gjetur në dosjen e aplikimit për fond nga Bashkia Vlorë dhe Nisma A, nuk ka numër protokollit, nuk është e firmosur nga Kryetari i Bashkisë dhe as nuk ka vulën e bashkisë Vlorë, por mbanë një firmë të njomë të pa identifikueshme në emër të Kryetarit të Bashkisë Z. D L, ndërkohë që në emër të partnerit A firma dhe vula e OJF është fotokopje. Nisur nga kjo mund të themi se në dosjen e aplikimit nuk ka një dokument zyrtar që vërteton partneritetin e Bashkisë Vlorë dhe Nisma A, ose bashkëpunimin e A me UNICEF në kuadër të de institucionalizimit.

#### III. 3. 2 Lidhja e marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë dhe Nisma A

##### a) Bashkia Korçë

Në vijimësi, Bashkia Korçë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 6013 datë 13.07.2021 me Nisma për Ndryshim Marrëveshja A. Në marrëveshje specifikohet se Bashkia Korçë dhe A kanë aplikuar si partner në kuadër të deinstitutionalizimit për financimin në fondin social të MSHMS, gjë e cila nga sa trajtuar më sipër nuk qëndron. Gjithashtu, në marrëveshje nuk specifikohen as personi i kontaktit për Bashkinë Korçë as i Nismës A. Këto marrëveshje i referohen marrëveshjes së bashkëpunimit të MSHMS me UNICEF dhe Save the Children me nr.6706 datë 22.11.2018 e cila ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit midis palëve për zbatimin e Planit të Veprimit për Deinstitutionalizimin të hartuar nga MSHMS dhe ky program bashkëpunimi ka afat për periudhën 2017-2021.

Në këtë marrëveshje nuk janë përfshirë as palët e tjera të interesit që përfshihen në këtë Plan Kombëtar si: MSHMS (financues dhe monitorues), Shërbimi Social dhe IPSH Korçë referuar Objektivit të pestë strategjik: Koordinimi në nivel kombëtar dhe monitorimi i zbatimit të planit kombëtar të deinstitutionalizimit. Gjithashtu në këtë marrëveshje janë përfshirë edhe një plan shpenzimesh në kuadër të deinstitutionalizimit si pagesë për shërbimet e kryera nga OJF Nisma A, ndryshe nga marrëveshjet e mëparshme për fazën e I të deinstitutionalizimit. Nisma A është anëtare e GTP-s, në cilësinë e ekspertit të jashtëm kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe njëkohësisht është paguar nga të dy bashkitë pilot për ofrimin e shërbimeve për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit.

##### b) Bashkia Vlorë

Bashkia Vlorë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr. 9993 datë 28.06.2021 me Nisma për Ndryshim Marrëveshja A. Në marrëveshje specifikohet se Bashkia Vlorë dhe A kanë aplikuar si partner në kuadër të deinstitutionalizimit për financimin në fondin social të MSHMS, gjë e cila nga sa trajtuar më sipër nuk qëndron. Gjithashtu, në marrëveshje specifikohet se duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak, por nga auditimi është konstatuar se marrëveshja është lidhur midis Bashkisë (Kryetari i Bashkisë) dhe Nismës A dhe nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak. Gjithashtu, në marrëveshje nuk specifikohen as personi i kontaktit për Bashkinë Vlorë as i Nismës A.

Në këtë marrëveshje nuk janë përfshirë as palët e tjera të interesit që përfshihen në këtë Plan Kombëtar si: MSHMS (financues dhe monitorues), Shërbimi Social dhe IPSH Vlorë referuar Objektivit të pestë strategjik: Koordinimi në nivel kombëtar dhe monitorimi i zbatimit të planit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

kombëtar të deinstitutionalizimit. Edhe në këtë kontratë është përfshirë një plan pagese kundrejt Nisma A për shërbimet e ofruara në kuadër të deinstitutionalizimit.

#### III. 3. 3 Ngritja e Strukturave të shërbimit

Në vijim të zbatimit të kontratës por dhe të planit të deinstitutionalizimit, nga Bashkia Korçë dhe Bashkia Vlorë, janë ngritur strukturat dhe është punësuar stafi i shërbimit mbështetës për fëmijët dhe familjen duke mos marrë për bazë objektivin për Transformim gradual i 9 IPSH-ve (institucione të shërbimeve të përkujdesjes) dhe hartimin i një programi konkret, si dhe pa u bërë miratimi paraprak i protokolleve dhe i mekanizmave të llogaridhënies për shërbimet e reja (të integruara në sistemin aktual të përkujdesjes shoqërore). Në Bashkinë Korçë, me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.59 Datë 03.06.2021 është miratuar struktura e përbërë me 8 punonjës, konkretisht:

Koordinatorë shërbimi, 2 Punonjëse Sociale, 2 psikologe, 2 kujdestare shtëpie për fëmijët dhe të rriturit dhe për kujdesin alternative dhe familjet PAK dhe 1 sanitare. Në total për vitin 2021 janë punësuar 8 punonjës për të cilët shpenzimet e pagave dhe sigurimeve të realizuara kanë qenë në vlerën 1,214,418 lekë. Në bashkinë Vlorë, me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.37 Datë 28.05.2021 është miratuar struktura e përbërë me 8 punonjës, konkretisht: Koordinatorë shërbimi, 2 Punonjëse Sociale, 2 psikologe, 2 kujdestare shtëpie për fëmijët dhe të rriturit dhe për kujdesin alternative dhe familjet PAK dhe 1 sanitare. Në total për vitin 2021 shpenzimet e pagave dhe sigurimeve të realizuara kanë qenë në vlerën 1,848,741 lekë. Ky staf ka nisur punën në kushtet kur ende nuk ka një bazë ligjore të rishikuar dhe nuk janë miratuar protokollat e punës në kundërshtim me objektivin e parë pa u bërë: Hartimin e udhëzimeve për profesionistët; hartimi i ndryshimeve ligjore, administrative dhe procedurale, bazuar në rekomandimet e studimit.

#### III. 3. 4 Shpenzimet e realizuara në kuadër të deinstitutionalizimit:

##### a) Bashkia Korçë

Shpenzimet e kryera në zbatim të marrëveshjes dhe planit të deinstitutionalizimit i referohen një plan buxheti të hartuar nga Nisma A, e cila është miratuar me urdhrin nr. 923 datë 08.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë:

		Viti 1			Viti 2			Viti 3		
		Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët	Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët	Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët
Pagat dhe kontributet	18,275,220	6,091,740			4,159,188	1,932,552		2,534,724	3,557,016	
Qera	2,160,000		720,000		720,000				720,000	
Shpenzime për	10,389,000	3,573,000	360,000		2,772,000		456,000	1,412,000	180,000	1,636,000



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

aktivitete sipas planit të punës										
Pilotimi I shërbimeve të kujdesit alternativ e profesional	4,566,000	450,000			258,000	1,800,000			2,058,000	
Ndërgjegjësimi I komitetit për kujdesin alternativ dhe mirëqenies së fëmijëve	880,000	880,000								
<b>Sub-total</b>	<b>36,273,220</b>									
Shpenzime të përgjithshme	3,060,000	820,000		200,000			1,020,000			1,020,000
<b>Total</b>	<b>39,621,220</b>	<b>11,814,740</b>	<b>1,080,000</b>	<b>200,000</b>	<b>7,909,188</b>	<b>3,732,552</b>	<b>1,476,000</b>	<b>3,946,724</b>	<b>6,515,016</b>	<b>2,656,000</b>

Tabela 3: Shpenzimet e detajuara/Burimi: Bashkia Korçë

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Nisma A nr. 6013 datë 13.07.2021 nga Bashkia Korçë janë kryer shpenzime për shërbime dhe materiale të prodhuara nga kjo OJF në kuadër të zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit.

#### Shpenzime për "Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit"

Nga auditimi është konstatuar se me urdhër shpenzimin nr.1570 datë 28.12.2021 nga Bashkia Korçë është bërë likuidimi i shpenzimeve për Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë për faturën nr.15/2021 datë 23.12.2021, por asnjë nga dokumentet bashkëlidhur urdhër shpenzimeve nuk është miratuar nga Bashkia Korçë në kundërshtim me nenin 4, pika vii dhe neni 5, pika ii të marrëveshjes.

Nëse i referohemi nenit 4: Përgjegjësitë e Palëve, të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe A, Bashkia Korçë ka për detyrë të shohë dhe të miratojë protokollin e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

shërbimit, politikat e mbrojtjes së klientëve të shërbimit si dhe të gjitha dokumentet e hartuara nga shoqata Nisma A. Gjithashtu, në shtojcën 1, të marrëveshjes parashikohet zëri për shpenzime të Hartimit të procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë, por për këtë zë nuk specifikohet se çfarë dokumente konkretë do të prodhohen në ndihmë të deinstitutionalizimit.

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se e njëjta skemë likuidimi është bërë dhe në Bashkinë Vlorë ku me urdhër shpenzimin nr. 1472 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.23 datë 28.12.2021 për shpenzime: Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë.

Nga verifikimi dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimeve në të dyja Bashkitë u konstatua se:

1. Termat e referencës për ngritjen e Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen nuk janë të miratuara dhe është i njëjti material si për Bashkinë Korçë dhe për Bashkinë Vlorë.
2. Protokollet, manualët e shërbimit përfshirë mekanizmat e llogaridhënies, Udhëzimi i pilotimit të shërbimit të kujdesit në familje nuk janë të miratuara dhe është i njëjti material si për Bashkinë Korçë dhe për Bashkinë Vlorë.

Kurse, nga auditimi i dokumentacionit të përcjellë me email nga Bashkia Korçë, rezultoi se Udhëzimi i pilotimit të shërbimit të kujdesit në familje mbante datën qershor 2021, ndërkohë që kontrata e bashkëpunimit është lidhur në korrik 2021.

Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot. Referuar pikës 3.5 të urdhrit të Ministrit të MSHSM nr.548 datë 01.10.2020 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tij këto materiale janë përgjegjësi e GTP dhe duhet të miratohen nga Komiteti Drejtues.

#### *Shpenzime për "Trajnime stafi, Mentorimi dhe Supervizimi"*

Nga auditimi është konstatuar se Bashkia Korçë ka kryer shpenzime në vlerën 552,000 lekë për trajnim kundrejt OJF-s: Nisma A në kushtet kur nuk kemi trajnime të miratuara, as manuale të miratuara dhe as protokolle pune në nivel kombëtar. Kjo në kundërshtim me Objektivin e katërt strategjik ku parashikohet zhvillimi dhe akreditimi i programeve të trajnimit aktuale dhe të reja, për të siguruar zbatimin e përfaqësive dhe modeleve të reja dhe të standardizuara të shërbimeve; hartimi dhe miratimi/akreditimi i paketës së trajnimeve për përkujdesjen alternativë ó për trajnimin fillestar dhe në vazhdim, bazuar në kurikulat aktuale në përdorim; hartimi i modulit/kurikulës së trajnimit për kujdesin për veten dhe jetesën gjysmë të pavarur Shpenzimet e realizuara për Shpenzime Trajnimi, Mentorimi dhe Supervizimi kundrejt Nisma A janë si më poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 1570 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.15/2021 datë 23.12.2021 për shpenzime: Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1571 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.16/2021 datë 23.12.2021 për shpenzime: Trajnimi i kujdestarëve alternativ profesionist në vlerën 450,000 lekë.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

- Me urdhër shpenzimin nr. 1568 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.13/2021 datë 23.12.2021 për shpenzime: Trajnimi i kujdestarëve alternativ profesionist në vlerën 60,000 lekë.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1569 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.14/2021 datë 23.12.2021 për shpenzime: Supervizim i punonjësve të shërbimit në vlerën 42,000 lekë.

Këto trajnime i referuar shtojcës 1: ÷Zërat e Buxhetit të kontratës së Bashkisë dhe A, edhe pse nga auditimi është konstatuar se në marrëveshja nuk specifikohet se tabela në faqen 8 është shtojca 1 e marrëveshjes.

<b>Shërbimet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kosto</b>	<b>Kosto totale</b>	<b>Realizuar</b>
<b>Shërbimet me bazë komunitare për fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimit.</b>				
Trajnime të stafit	10 ditë	35,000	350,000	350,000
Mentorimi i punonjësve të shërbimit	72 ditë	2,500	180,000	60,000
Supervizimi i punonjësve të shërbimit	36 ditë	3,500	126,000	42,000
Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit	25 ditë	13,000	325,000	325,000
<b>Pilotimi i shërbimeve të kujdesit alternativ profesional</b>			<b>981,000</b>	<b>770,000</b>
Trajnim i Kujdestarëve alternativ profesional	15 ditë	30,000	450,000	450,000
Mentorim i kujdestarëve alternativ profesionale	72 ditë	2,500	180,000	
Supervizim i kujdestarëve alternativ profesional	96 ditë	3,500	336,000	
<b>Sub total</b>			<b>966,000</b>	<b>450,000</b>
<b>Total</b>			<b>1,947,000</b>	<b>1,227,000</b>

*Tabela 4: Shpenzimet e detajuara/Burimi: Bashkia Korçë*

Nga Bashkia Korçë janë kryer *Shpenzimet për aktivitetet sipas planit të punës*, të cilat janë shpenzime për shërbimet me bazë komunitare për fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimit. Nga auditimi konstatohen se këto shpenzime i referohen një plan buxheti të hartuar nga Nisma A të pamiratuara gjatë aplikimit për fond në MSHMS në vlerën totale prej 1,362,037 lekë për shpenzimet e më poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 1533 datë 23.12.2021 është paguar fatura nr.4719/2021 datë 15.12.2021 për blerje mjete higjenosantare në vlerën 123,000 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.83 datë 15.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1534 datë 23.12.2021 është paguar fatura nr.4721/2021 datë 15.12.2021 për blerje ÷Mjete kancelarie në vlerën 78,000 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.84 datë 15.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1492 datë 20.12.2021 është paguar fatura nr.422/2021 datë 13.12.2021 për blerje ÷telefon celular në vlerën 20,000 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.81 datë 13.12.2021.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

- Me urdhër shpenzimin nr. 1535 datë 23.12.2021 është paguar fatura nr.663/2021 datë 20.12.2021 për blerje materiale promocionale në vlerën 599,147 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.88 datë 20.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1536 datë 23.12.2021 është paguar fatura nr.99/2021 datë 17.12.2021 për blerje paketë veshmbathje për raste emergjente në vlerën 448,800 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.87 datë 17.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1577 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.19/2021 datë 24.12.2021 për blerje mjete didaktike në vlerën 93,090 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.90 datë 24.12.2021.

Pas marrjes në dorëzim, mallrat janë bërë dalje nga magazine dhe janë marrë në dorëzim nga zj. M.Sh. me fletëdaljet: fletëdalja nr.603 datë 24.12.2021, fletëdalja nr.580 datë 13.12.2021, fletëdalja nr.586 nr.15.12.2021, fletëdalja nr.587 datë 15.12.2021, fletëdalja nr.595 datë 20.12.2021 dhe fletëdalja nr.593 datë 17.12.2021. Menaxhimi i këtyre mallrave bëhet nga stafi i SHMFF ku lidhur me veshmbathjet, detergjentët dhe mjetet didaktike shpërndarja bëhet sipas emergjencave.

#### **b) Bashkia Vlorë:**

Shpenzimet e kryera në zbatim të marrëveshjes dhe planit të deinstitutionalizimit i referohen një plan buxheti të hartuar nga Nisma A, i cili nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë:

		Viti 1			Viti 2			Viti 3		
		Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët	Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët	Kontri bute nga fondi social	Kontri bute nga bashkia	Partnerët
Pagat dhe kontributet	18,275,220	6,091,740			4,159,188	1,932,552		2,534,724	3,557,016	
Qera	1,800,000		600,000		600,000				600,000	
Shpenzime për aktivitete sipas planit të punës	10,932,000	3549000	480000		2814000		588000	1412000	1680000	1798000
Pilotimi I shërbimeve të kujdesit	4,566,000	450000			408000	165000			1908000	





**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

alternativ e profesional										
Ndërgjegjësimit I komitetit për kujdesin alternativ dhe mirëqenies së fëmijëve	700,000	700,000								
<b>Sub-total</b>	<b>36,273,220</b>									
Shpenzimet të përgjithshme	3,348,000	892,000		2,000			1,116,000			1,116,000
<b>Total</b>	<b>39,621,220</b>	<b>1,168,740</b>	<b>108,000</b>	<b>2,000</b>	<b>798,118</b>	<b>35,825,52</b>	<b>1,704,000</b>	<b>394,672</b>	<b>623,316</b>	<b>291,400</b>

Tabela 5: Shpenzimet e detajuara/Burimi: Bashkia Vlorë

Sa më sipër, është në kundërshtim me objektivin e parë, të planit të deinstitutionalizimit i cili parashikon rregullimin e kuadrit financiar të shërbimeve të reja të përkujdesjes shoqërore të modeluara në kuadër të deinstitutionalizimit si: hartimin dhe kostimin e paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki; hartimin dhe kostimin e modeleve të reja të shërbimit, hartimin dhe kostimin e programit të standardizuar të ribashkimit të fëmijës me familjen.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Nisma Ame nr. 9993 datë 28.06.2021 nga Bashkia Vlorë janë kryer shpenzime për shërbime dhe materiale të prodhuara nga kjo OJF në kuadër të zbatimit të planit të Deinstitutionalizimit.

*Shpenzime për "Hartimin e procedurave, rregulloreve dhe manualeve"*

Nga auditimi është konstatuar se me urdhër shpenzimin nr. 1472 datë 28.12.2021 nga Bashkia Vlorë është bërë likuidimi i shpenzimeve të Hartimit i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë për faturën nr.23 datë 28.12.2021, por asnjë nga dokumentet bashkëlidhur urdhër shpenzimeve nuk është miratuar nga Bashkia Vlorë në kundërshtim me nenin 4, pika vii dhe neni 5, pika ii të marrëveshjes.

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se e njëjta skemë likuidimi është bërë dhe në Bashkinë Korçë ku me urdhër shpenzimin nr. 1570 datë 28.12.2021 është paguar fatura nr.15/2021 datë 23.12.2021 për shpenzime: Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit në vlerën 325,000 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

#### “Shpenzime Trajnimi, Mentorimi dhe Supervizimi”

Nga auditimi është konstatuar se Bashkia Vlorë ka kryer shpenzime në vlerën 902,000 lekë për trajnim kundrejt OJF-s: Nisma A në kushtet kur nuk kemi trajnime të miratuara, as manuale të miratuara dhe as protokolle pune në nivel kombëtar. Shpenzimet e realizuara për Shpenzime Trajnimi, Mentorimi dhe Supervizimi kundrejt Nisma A janë si më poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 1476 datë 28.12.2021 është paguar vlera 350,000 lekë për shërbimin e mentorimit të punonjësve të shërbimit me faturën nr.20 datë 28.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1475 datë 28.12.2021 është paguar vlera 60,000 lekë për shërbimin e trajnimit të stafit me faturën nr.21 datë 28.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1473 datë 28.12.2021 është paguar vlera 42,000 lekë për shërbimin e trajnimit të stafit me faturën nr.22 datë 28.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1471 datë 28.12.2021 është paguar vlera 450,000 lekë për shërbimin e trajnimit të stafit me faturën nr.24 datë 28.12.2021.

Këto trajnime i referuar shtojcës 1: ÷Zërat e Buxhetit të kontratës së Bashkisë dhe A, edhe pse nga auditimi është konstatuar se në marrëveshja nuk specifikohet se tabela në faqen 8 është shtojca 1 e marrëveshjes.

Shërbimet	Sasia	Kosto	Kosto totale	Realizuar
Shërbimet me bazë komunitare për fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimit.				
Trajnime të stafit	10 ditë	35,000	350,000	350,000
Mentorimi i punonjësve të shërbimit	72 ditë	2,500	180,000	60,000
Supervizimi i punonjësve të shërbimit	36 ditë	3,500	126,000	42,000
Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit	25 ditë	13,000	325,000	325,000
<b>Pilotimi i shërbimeve të kujdesit alternativ profesional</b>			<b>981,000</b>	<b>770,000</b>
Trajnim i Kujdestarëve alternativ profesional	15 ditë	30,000	450,000	450,000
Mentorim i kujdestarëve alternativ profesional	72 ditë	2,500	180,000	
Supervizim i kujdestarëve alternativ profesional	96 ditë	3,500	336,000	
<b>Sub total</b>			<b>966,000</b>	<b>450,000</b>
<b>Total</b>			<b>1,947,000</b>	<b>1,227,000</b>

Tabela 6: Shpenzimet e detajuara/Burimi: Bashkia Vlorë

Nga Bashkia Vlorë janë kryer shpenzimet për aktivitetet sipas planit të punës, të cilat janë shpenzime për shërbimet me bazë komunitare për fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimit. Nga auditimi konstatohen se këto shpenzime i referohen një plan buxheti të hartuar nga Nisma A por të pamiratuara gjatë aplikimit për fond në MSHMS në vlerën totale prej 1,699,093 lekë për shpenzimet e më poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 1420 datë 16.12.2021 është paguar fatura nr.240 datë 13.12.2021 për blerje mjete didaktike në vlerën 114,120 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.240 datë 13.12.2021.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

- Me urdhër shpenzimin nr. 1336 datë 06.12.2021 është paguar fatura nr.35 datë 26.11.2021 për blerje paketash higjenosanitare në vlerën 492,000 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.68 datë 26.11.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1453 datë 22.12.2021 është paguar fatura nr.15 datë 20.12.2020 për blerje paketash ushqimore në vlerën 450,000 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.94 datë 20.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1421 datë 16.12.2021 është paguar fatura nr.241 datë 13.12.2021 për blerje detergjentesh në vlerën 80,173 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.78 datë 13.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1337 datë 06.12.2021 është paguar fatura nr.23 datë 02.12.2020 për blerje bluzash në vlerën 348,120 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.70 datë 02.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1419 datë 16.12.2021 është paguar fatura nr.242 datë 13.12.2020 për blerje shtypshkrimesh në vlerën 112,200 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.79 datë 13.12.2021.
- Me urdhër shpenzimin nr. 1449 datë 20.12.2021 është paguar fatura nr.41 datë 19.12.2021 për blerje fletëpalosje, çanta, stilolapsa për projektin në vlerën 102,480 lekë. Bashkëlidhur këtij urdhër shpenzimi është fatura dhe fletëhyrja e magazinës nr.91 datë 20.12.2021.

Pas marrjes në dorëzim, mallrat janë bërë dalje nga magazine dhe janë marrë në dorëzim nga zj. Stela Mërtiraj, Koordinatore e SHMFF. Menaxhimi i këtyre mallrave bëhet nga stafi i SHMFF ku lidhur me ÷veshmbathjet, detergjentët, mjetet didaktike dhe ushqimet shpërndarja bëhet sipas emergjencave.

#### **Titulli i gjetjes nr. 11: Janë paguar shpenzime për trajnime, mentorime dhe supervizime jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore**

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma ApëroTrajnime stafi, mentorime dhe supervizime. Nga Bashkia Vlorë është paguar në total vlera 902,000 lekë dhe nga Bashkisë Korçë është paguar vlera 877,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishin kryer nga të dy bashkitë pilot për sa më poshtë:

- Referuar urdhrat të Ministrit të MSHSM nr. 548 datë 01.10.2020 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tij zbatimi i planit të deinstitutionalizimit do të jetë përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës (GTP) në dakordësi me Komitetin Teknik të ngritur pranë MSHMS. GTP është i përbërë nga përfaqësues të MSHMS, përfaqësues në Shërbimit Social Shtetëror, përfaqësues të ASHDMF-së, Ekspertë të jashtëm të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe të tjerë sipas nevojës por nga sa u konstatua përveç Nisma A për ofrimin e këtyre shërbimeve nuk është përfshirë asnjë anëtar tjetër i GTP-s siç edhe duhet të ishte për zhvillimin e modeleve sa më cilësore.
- Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A si pjesë e GTP-s janë të kontraktuar nga partnerët



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë shërbime për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga dy bashkitë pilot. Bashkia Korçë dhe Vlorë nuk duhet të realizonin pagesa për shpenzime trajnimesh, mentorime dhe supervizime kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save the Children do të jetë për mbështetje teknike ndaj këtij plani, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë përfutues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.

- Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar sipas emërimit, orëve dhe çmimit për orë pune nga vetë Bashkitë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 1,779,000 lekë për òtrajtime, mentorime dhe supervizime për të dy bashkitë pilot.

**Kriteri:** Neni 4, pika 4.3, germa iii, Memorandumit i mirëkuptimit nr. 6706 datë 22.11.2018 Ndërmjet MSHMS, UNICEF dhe Save the Children dhe vendimi nr. 706 datë 09.09.2020 Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit.

**Ndikimi:** Janë kryer shpenzime për trajnim padrejtësisht

**Shkaku:** Nuk janë marrë masat e duhura as nga Bashkitë as nga MSHMS

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **877,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

**Rekomandimi 2:** Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **902,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

**Titulli i gjetjes nr. 12: Janë paguar “shpenzime për protokolle, udhëzime dhe terma reference” jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore**

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma Apërdragt dokumentet “Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimitö. Nga Bashkia Vlorë me urdhër shpenziminnr. 1472 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë dhe nga Bashkisë Korçë me urdhër shpenzimit nr. 1570 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishin kryer nga të dy bashkitë pilot për sa më poshtë:

- Referuar pikës 3.5 të urdhrit të Ministrit të MSHSM nr. 548 datë 01.10.2020 öPër ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tijö këto materiale



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

janë përgjegjësi e GTP dhe do të miratohen nga Komiteti Drejtues.

- Në nenin 4 të marrëveshjeve të bashkëpunimit Bashkive dhe Nisma A: përcaktohet se këto materiale duhet të miratohen nga Bashkitë respektive të cilat rezultoi se ishin draft dokumente dhe të pamiratuara.
- Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A të cilët kanë hartuar: *“Termet e referencës për ngritjen e Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen, Protokollet, manualët e shërbimit përfshirë mekanizmat e llogaridhënies, Udhëzimi i pilotimit të shërbimit të kujdesit në familje”* dhe janë pjesë e GTP-s, duhet të kishte rol mbështetës për këtë plan si të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe jo të paguhen për shërbimet e realizuara në këto bashki pilot.
- Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar nga vetë Bashkitë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 650,000 lekë për draft dokumentet e prodhuara për dy bashkitë pilot.

**Kriteri:** Neni 4, pika vii dhe neni 5, pika ii marrëveshjet nr. 6013 datë 13.07.2021 dhe nr. 9993 datë 28.06.2021.

**Ndikimi:** Janë likuiduar shpenzime për materiale draft dhe pa një produkt final

**Shkaku:** Nuk janë verifikuar dhe miratuar materialet e dorëzuara nga Nisma A.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **325,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për òHartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimito ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

**Rekomandimi 2:** Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **325,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për òHartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimito ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

**Rekomandimi 3:** Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Grupi Teknik i Punës dhe Komiteti Drejtues të merren për rishikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit. Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot, në mënyrë të tillë, që nëse ky plan rezulton i suksesshëm në dy bashkitë pilot të vijojë të ndiqet në nivel kombëtar. Prandaj përfshirja e anëtarëve të GTP në hartimin e këtyre dokumenteve dhe miratimi i dokumenteve nga Komiteti Drejtues është proces shumë i rëndësishëm.

**Menjëherë**

**Titulli i gjetjes nr. 13: Janë paguar “shpenzime të përgjithshme” jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga Bashkia Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma A me urdhër shpenzimit nr. 1572 datë 28.12.2021 për shpenzimet: ÷Menaxhim shërbimi në vlerën 180,000 lekë, ÷Oficer financeo në vlerën 150,000 dhe ÷Logjist/shofero në vlerën 80,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishte kryer nga Bashkia Korçë për sa më poshtë:

- Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A si pjesë e GTP-s janë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë shërbime për zbatimin e planit të Deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga bashkia pilot. Bashkia Korçë nuk duhet të realizonte pagesa për shpenzime ÷Menaxhim shërbimi, ÷Oficer financeo dhe ÷Logjist/shofero kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save the Children do të jetë për mbështetje teknike ndaj këtij plani, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë përfitues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.
- Në kontratat e punësimit të këtyre punonjësve të hartuara nga nisma A nuk është përfshirë bashkia si palë interesi dhe si përfituese e këtij shërbimi por është mjaftuar vetëm në kontratat e lidhura nga Nisma A me punonjësit. Gjithashtu shërbimi që është ofruar nga ÷Oficer Financeo dhe ÷Logjist/Shofero nuk dokumentohet nga Bashkia Korçë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 410,000 lekë për shërbime të kryera nga personeli i punësuar prej saj, për një punë të pa dokumentuar dhe pa detyrime juridike për Bashkinë Korçë.

**Kriteri:**

Ligji nr.7961 datë 12.07.1995 ÷Kodi i punës, Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 ÷Menaxhimi i aktiveve.

**Ndikimi:**

Shpenzime padrejtësisht

**Shkaku:**

Janë paguar shpenzime pagash për punonjës të punësuar nga A pa asnjë kontratë me Bashkinë Korçë

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **410,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për ÷menaxhim shërbimi, ÷oficer financeo dhe ÷shofero ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

*Observacioni mbi Projektraportin për auditimin e kryer ne Bashkinë Korçë nr.1267/16 datë 04.05.2022 nga Bashkia Korçë.*

**Pretendimi i subjektit:**

*Observime mbi gjetjen nr.11 nga Bashkia Korçë*

Për sa i përket shpenzimeve të kryera për trajnime, supervizim dhe mentorim, Bashkia Korçë është bazuar në punën e kryer për trajnime, supervizime dhe mentorim nga ekipi i Nisma A,



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHËTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

sipas projekt propozimit dhe buxhetit të miratuar nga MSHMS...Shërbimi i mentorimit dhe supervizimit vijon të ofrohet edhe përgjatë vitit 2022 dhe njëkohësisht nuk ka asnjë komunikim nga MSHMS si autoritet miratues i fondit social dhe projekt propozimit për udhëzime të tjera.

Observime mbi gjetjen nr.12 nga Bashkia Korçë

Për sa i përket pagesës së kryer padrejtësisht shpenzime për protokolle, udhëzime dhe terma reference, Bashkia Korçë shpreh angazhimin për të respektuar rekomandimin e nr.3 të grupit të auditimit, dhe në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës...Aktualisht Bashkia Korçë po vijon punën me Nisma A për implementimin e gjithë dokumenteve të hartuara për pilotimin me sukses të projektit dhe në këto kushte bashkia njej procedurën e kryer...

Observime mbi gjetjen nr.13 nga Bashkia Korçë

Bashkia Korçë ka vlerësuar se kontratat me punonjësit do të lidheshin nga vetë Shoqata Nisma A si pjesë e shërbimit të ofruar dhe marrëveshjes midis Bashkisë dhe Nisma A...Bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion të gjithë dokumentacionin ku i mbështesim argumentimet e mësipërme.

*Observacioni mbi për auditimin e kryer ne "Bashkinë Korçë dhe Vlorë" nr.1267/18 datë 04.05.2022 nga Nisma A.*

#### **Pretendimi i subjektit:**

Observime mbi gjetjen nr.11 nga Nisma A

mbi konstatimin e pikës A: Qeveria Shqiptare me vëmendje ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror të vendosur në shërbimet rezidenciale në 22 nëntor të vitit 2018 vendosi të përforcojë këtë angazhim...Pra trajnimet e ofruara nga shoqata Nisma në kuadër të ngritjes së SHMFF nuk kanë mbivendosur trajnimet e ofruara nga SC për vlerësimin e fëmijëve dhe aq më tepër nuk kanë prekur 3 institucionet e cituara në memorandumun që ju citoni.

mbi konstatimin e pikës B: Në memorandumun e përmendur dhe në konstatimin A,...pasi i referohen përgjegjësive të ndryshme që Nisma ka ndërmarrë në të dyja rastet.

mbi konstatimin e pikës C: Në buxhetin e miratuar nga MSHMS për fondin Social...miratuar me VKM nr.637 dt.27.10.2021..

mbi konstatimin e pikës D: Për sa i përket takimeve dhe dokumentacionit justifikues...Gjithsesi sqarojmë se këto minuta takimi i përkasin projektit të cituar dhe nuk i përkasin asnjë aktiviteti që është i buxhetuar nga marrëveshja e lidhur me fondin social por në kuadër të partneritetit Nisma me UNICEF dhe me bashkinë Vlorë dhe Korçë për avancimin e procesit të deinstitutionalizimit.

Observime mbi gjetjen nr.12 nga Nisma A:

Shoqata Rekomandimi 1&2: Nisma ka hartuar dokumentet si më poshtë: ....Rekomandimi 3 Nisma shpjegon...të cilat grupi i ka marrë në konsideratë në projek raport.

Observime mbi gjetjen nr.13 nga Nisma A: Punonjësi z. T.S. ka kontratë me kohë të plotë me shoqatën Nisma. PAGESA E TIJ MUJORE MBULOHEK nga dy partnerë. Bashkia Korçë ka mbuluar vetëm pjesën e pagës që lidhet me kohën e shpenzuar për funksion të SHMFF...Dokumentacioni i plotë që vërteton sa më sipër gjendet bashkëngjitur këtij observacioni.

*Observacioni mbi Projektraportin për auditimin e kryer ne Bashkinë Vlorë nr.1267/17 datë 04.05.2022 nga Bashkia Vlorë.*

#### **Pretendimi i subjektit:**

III.3.4 Shpenzimet e realizuara në kuadër të deinstitutionalizimit (fq.6)...Në rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit pikërisht për gjetjet nr.7 i lihet detyrë për marrjen e masave të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

menjëhershme për shqyrtimin dhe miratimin e setit të manualeve dhe udhëzimeve apo protokolleve të paraqitura...(fq.8)

*Observacioni mbi Projektraportin për auditimin e kryer ne Bashkinë Korçë nr.1267/20 datë 13.05.2022 nga Bashkinë Korçë.*

Dërgim dokumentesh mbas diskutimit në takimin ballafaques.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Lidhur me observimet e mësipërme:*

Lidhur me sa ju observoni për gjetjen nr.11: Marrëveshja e Bashkëpunimit të MSHMS me UNICEF dhe Save the Children me nr.6706 datë 22.11.2018 ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit midis palëve për zbatimin e Planit të Veprimit për Deinstitutionalizimin të hartuar nga MSHMS dhe ky program bashkëpunimi ka afat për periudhën 2017-2021. Pra kjo marrëveshje vlen dhe për periudhën objekt auditimi. Gjithashtu edhe marrëveshja e bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë, Vlorë- Nisma A i referohet këtij bashkëpunimi. Lidhur me sa ju observoni marrim pjesërisht në konsideratë se këto trajnime nuk janë detyrë e vetme e SC por nëse i referohemi urdhrat të Ministrit të MSHSM nr.548 datë 01.10.2020 òPër ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tij vëmë re se kjo është një kompetencë e Grupit Teknik të Punës. Konkretisht në këtë urdhër citohet se: GTP është përgjegjës për zhvillimin e modeleve të reja të shërbimeve dhe dokumenteve të tjerë strategjike në zbatimin e planit, prezantimin dhe rishikimin e tyre; ; modelimin e Supervizimit Profesional dhe ndjekjen e ofrimit të supervizimit, të punonjësve të IPSH-ve publike; Monitorimin e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, nga shërbimi Social Shtetëror; hartimin e moduleve dhe kalendarit të trajnimeve për punonjësit e IPSH-ve, për sa i përket ndryshimit të modelit të shërbimeve nga ato rezidenciale, në ato me bazë komunitare, përfshirë sigurimin e interesit më të lartë të fëmijëve. Ky grup teknik i punës përbëhet nga: Përfaqësues të MSHMS, përfaqësues në Shërbimit Social Shtetëror, përfaqësues të ASHDMF-së, Ekspertë të jashtëm të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe të tjerë sipas nevojës. Referuar këtij urdhri, GTP është i përbërë òdhe nga Ekspertë të jashtëmò (pra jo vetëm), rasti konkret Nisma A, por që janë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe jo nga vetë Bashkitë pilot. Për aq kohë sa Nisma A është e kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar (fakt ky i pavërtetuar me dokumentacion) përse kryen shërbime me pagesë kundrejt Bashkive pilot për shërbime të cilat duhet të kontribuohet nga të gjithë përfaqësuesit e GTP-s?! Aq më tepër kur ju vetë citoni në dosjen e aplikimit për fonde nga Bashkia Korçë dhe Vlorë, se: Nisma A, zotëron ekspertizën, përvojën, burimet materiale dhe stafin e kualifikuar dhe si OJF ka aftësi të përthithë fonde dhe burime alternative nga donatorë, biznesi dhe dhurime nga palë të treta për të siguruar të paktën edhe për dy vjet gamën dhe standardet e kërkuara të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen. Po ashtu, nëse i referohemi marrëveshjeve të mëparshme për fazën I të deinstitutionalizimit ju nuk keni kryer shërbime me pagesë pasi keni qenë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar.

Gjithashtu, lidhur me zërin òtrajnime të stafitò për të cilat është bërë pagesa: Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është bërë miratimi i buxhetit për këto shpenzime të cilat janë të shprehura në zë total dhe nuk janë të përcaktuara sipas emërimit, orëve dhe çmimit për orë pune. Së fundmi, për aq kohë sa zhvillimi i trajnimeve është kompetencë e GTP-s nuk ka vend për zhvillimin e trajnimeve **me pagesë** nga kjo organizatë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

Lidhur me sa ju observoni për gjetjen nr.12: Këto materiale duhet të ishin hartuar nga GTP dhe miratuar nga Komiteti drejtues dhe jo vetëm nga OJF Nisma A. Gjithashtu, buxheti për këto shpenzime nuk është miratuar nga Bashkia Korçë si dhe për aq kohë sa Nisma A është **kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar** përse duhet të paguhet dhe nga Bashkia Korçë për ofrimin e këtij shërbimi?! Për më tepër nuk mund të bëhet likuidimi i këtyre shpenzimeve për produkte të cilat nuk janë final por janë në formë draft.

Lidhur me observimin tuaj për gjetjen nr.13: Kontratat që keni lidhur me këta punonjës duhet të kishin përfshirë dhe Bashkinë Korçë si palë interesi përfituese dhe së fundmi, për aq kohë sa jeni partner me UNICEF ju financoheni nga partnerët ndërkombëtar për shërbimet që kryeni ashtu sikurse keni bërë për fazën I të Deinstitutionalizimit.

Duke qenë se gjatë fazës së auditimit në terren, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion të gjitha dokumentet, të cilat u diskutuan dhe në takimin ballafaques, grupi ka bërë korrigjimet e nevojshme në materialin e raportit përfundimtar. Një pjesë e pretendimeve tuaja janë reflektuar megjithatë në vazhdojmë ti qëndrojmë konstatimit tonë lidhur me shpenzimet e kryera. Kemi bërë reflektime për disa nga pretendimet tuaja megjithatë në lidhje me shpenzimet e konstatuara si të padrejta nga Bashkia Korçë dhe Vlorë kundrejt OJF Nisma A këto observacione nuk mund të merren në konsideratë.

## VI. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim MSHMS) nuk është konkluduar rivendosja në afat e Planit Kombëtar për Deinstitutionalizimin dhe efektet e tij, duke krijuar konfuzion si në zbatimin e afateve, po ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë plan. Janë diskutuar afatet e reja të zbatimit të këtij plani dhe janë përfshirë në Progres raportin e vitit 2021 të miratuar nga Komiteti në janar të vitit 2022, por këto ende nuk janë reflektuar në përditësimin e tij.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 1) faqe (9) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të integruar Planin e Veprimit me afatet e rivendosura me Progres raportin e vitit 2021, miratuar në janar të vitit 2022, me qëllim zbatimin e Planit të Veprimit në kohë dhe me cilësi.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS nuk është dokumentuar konsultimi me ministritë e linjës, agjencitë zbatuese dhe grupet e interesit, për draftin e ndryshimeve ligjore të propozuara, në kundërshtim me objektivin nr. 1.1/c të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit miratuar me VKM nr. 706, datë 09.09.2020 për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Gjithashtu nga e njëjta strukturë në MSHMS nuk është realizuar hartimi i akteve nënligjore/moduleve dhe udhëzuesve sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë, në kundërshtim me objektivin nr. 1.1/d të Planit cituar më lart,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

si dhe nuk është realizuar hartimi dhe kostimi i paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki, në kundërshtim me objektivin nr. 1.2/a.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 1) faqe (9) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të realizuar në afat dhe me cilësinë e kërkuar të gjithë objektivat e përcaktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e PKD.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Shërbimi Social Shtetëror (në vijim SHSSH), nuk është përfshirë me një rol aktiv në zbatimin e Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit dhe Planin e Veprimit në zbatim të tij, si shërbim që lidhet direkt me deinstitutionalizimin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 1) faqe (9) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të inkuadruar dhe ngarkuar me detyra konkrete SHSSH në procesin e realizimit të objektivave të Planit të Veprimit për deinstitutionalizimin.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni që administrojnë MSHMS për projekt propozimin e Bashkisë Vlorë rezulton se, për dorëzimin e projekt propozimit, Kryetari i Bashkisë Vlorë, i është drejtuar MSHMS me shkresën nr. 10417, datë 12.11.2020 dhe protokolluar në MSHMS me nr. 4716, datë 17.11.2020, nëpërmjet të cilës dërgon Planin Social të Bashkisë dhe VKB përkatëse, NIPT-in, si dhe projekt propozimin. Ndërkohë në dosjen e vënë në dispozicion, administrohet gjithashtu shkresa me nr. 10417, datë 13.11.2020, e sigluar nga Titullari i Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë, në emër të Kryetarit të Bashkisë, ku krahas sa më lart janë shtuar edhe dokumentet e nevojshme të partnerit (Nismës A). Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk është e qartë se kujt i drejtohet shkresa e mësipërme, ajo nuk përmban vulën e institucionit, nuk është e protokolluar në MSHMS dhe përmban të njëjtin nr. protokoll me shkresën e dërguar nga titullari i Bashkisë Vlorë dërguar një ditë më parë. Po kështu, nga auditimi rezulton se CD e bashkëlidhur shkresës së Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, është bosh dhe nuk përmban asnjë nga dokumentet që citohen në shkresë. Së fundmi, sa i takon projekt propozimit, në dosje gjendet dokumenti ÷Deklaratë Partneriteti, me anë të të cilës palët kanë shprehur vullnetin për të aplikuar si partnerë në projekt propozimin e dërguar MSHMS. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti, rezulton se ai daton më 13.11.2020 dhe mban nënshkrimin e Titullarit të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë, në emër të Kryetarit të Bashkisë dhe nuk është i protokolluar në BV. Nga auditimi rezultoi se ky dokument nuk përfshihet në listën e dokumenteve të cituara në shkresën e Kryetarit të Bashkisë, e cila ligjërisht përmban të gjithë elementët e një shkrese zyrtare, pra konstatohet se më datë 12.11.2020 kur është dorëzuar zyrtarisht aplikimi për Fondin Social, nuk ka patur partneritet me ndonjë organizatë mbështetëse.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 1) faqe (17) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Vlorë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresore zyrtare në shkëmbimet mes njërive.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Me miratimin e projekt propozimit të Bashkisë Vlorë dhe financimin e tij nga Fondi Social, Bashkia Vlorë me VKB nr. 37, datë 27.05.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen, përbërë prej 8 pozicionesh, në varësinë e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social. Nga auditimi rezultoi se për këtë strukturë nuk ka përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë përditësimet përkatëse në rregulloren e funksionimit. Si pasojë nuk ka qartësi dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet strukturës së Shërbimit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Familjes (në vijim SHMFF) dhe PMF (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës). Referuar Rregullores së brendshme të funksionimit, struktura e PMF ka për detyrë identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe referimin e tyre, por pa u përcaktuar qartë se në cilat struktura referohet rasti. Krahas sa më lart, nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Vlorë aktualisht nuk ka një person në rolin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 1) faqe (17) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Vlorë, të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës për secilin nga pozicionet e strukturës së ShMFF, duke përcaktuar qartë dallimet dhe ndarjen e kompetencave me PMF, si dhe të përfshijë këto ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi struktura e ShMFF është angazhuar vetëm në parandalimin e institucionalizimit dhe jo në deinstitutionalizimin e fëmijëve që aktualisht ndodhen në qendrën rezidenciale. Konkretisht, që nga ngritja e saj dhe në përmbushje të rezultateve të parashikuara, kjo strukturë ka patur një bashkëpunim efektiv në parandalimin e institucionalizimit dhe mbështetjen e familjeve që rrezikojnë braktisjen. Deri më taninuk është realizuar vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës, për arsye se SHMFF nuk disponon akses në dosjet e fëmijëve rezident në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, si dhe nuk janë realizuar takime individuale me këta fëmijë. Po kështu, sa i takon përsëri mangësive në procesin e deinstitutionalizimit, gjatë fazës së terrenit në Bashkinë Vlorë, grupi i auditimit konstatoi se në muajin dhjetor 2021, në IPSh Vlorë ishin institucionalizuar 2 fëmijë në shkëlqe të Moratoriumit të vendosur në VKM nr. 706, datë 09.09.2020. Për të dy rastet, ShMFF nuk kishte dijeni pasi zyrtarisht këto raste nuk i ishin referuar nga struktura përkatëse për mbrojtjen e fëmijës. Sa i takon fuqizimit të zbatimit të kujdesit alternativ, është realizuar nga A dhe ShMFF prezantimi i modelit të Kujdestarisë Alternative Profesionale KAP me administratoret e Rajoneve, organizatave e OJF. Megjithatë, ende nuk rezultoi të jenë identifikuar apo ofruar familje potenciale vullnetare për aplikimin e kujdestarisë alternative.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 1) faqe (17) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Vlorë, Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social dhe ShMFF, të marrin masa për fuqizimin dhe angazhimin me seriozitet në rolin e strukturave kyçe në procesin e deinstitutionalizimit, duke analizuar shkaqet e zvarritjes së këtij procesi dhe duke hartuar plane specifike pune me veprime konkrete për zgjidhjen e këtyre pengesave, si dhe duke i mbështetur këto veprime me fushata intensive sensibilizimi për rëndësinë e këtij procesi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vlorë në rolin e organit kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit të ri të ngritur, nuk ka garantuar të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimit të ri në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore, nisur nga fakti i mos referimit të rasteve nga PMF te ShMFF, apo mos marrja e masave për propozimin e integritit të kësaj strukture në Rregulloren e brendshme të funksionimit, veprime që duhet të ishin ndërmarrë nga Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social. Po kështu, Bashkia nuk ka vënë në dispozicion mjediset për ofrimin e shërbimeve. Gjatë vizitave në terren u konstatua se struktura e ShMFF është akomoduar në godinën e IPSh, ku i janë vendosur në dispozicion vetëm dy ambiente të cilat kanë formën e ambienteve të magazinimit. Njëri nga ambientet përdorej pikërisht për magazinimin e bankës së ushqimit, ndërsa në ambientin tjetër qëndronin stafi i psikologëve, punonjësve social dhe kujdestareve, në mungesë të plotë të logjistikës së nevojshme. Këto dy hapësira nuk ofrojnë elementët e nevojshëm të një qendre që do të ofrojë shërbime psiko-sociale, klasa prindërimi, shërbime këshillimi, takime me palët e interesit, akses për personat AK, etj. Sa i takon rishikimit dhe miratimit të protokolleve të shërbimit, politikave të mbrojtjes së klientëve, si dhe të gjitha dokumenteve të hartuara nga Nisma A, rezulton se kjo e fundit ja ka nisur dokumentacionin e prodhuar Bashkisë Vlorë në mënyrë elektronike dhe nuk janë shoqëruar me shkresë zyrtare në protokollin e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni i hartuar nga Nisma A nuk është marrë në dorëzim nga askush dhe deri në momentin e auditimit, ato nuk janë miratuar dhe as nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë për rishikimin e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 1) faqe (17) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi :** Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social të marrin masa për angazhimin me seriozitet dhe mbështetjen me të gjithë kapacitetet apo logjistikën e nevojshme në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjes. Duke qenë se në dokumentet e politikave flitet për transformim të shërbimit, këto struktura të marrin masa për gjetjen e një zgjidhje së pari sa i takon ambienteve, duke integruar brenda hapësirave të rezidencës aktuale të ISHP dhe zyrave të ShMFF, të gjitha shërbimet që parashikon mbështetja për fuqizimin e fëmijës dhe familjes.

**Menjëherë**

**7.2 Rekomandimi:** Bashkia Vlorë të marrë masa për shqyrtimin dhe miratimin e të gjithë setit të manualeve, udhëzuesve, apo protokolleve të paraqitur nga Nisma A, duke i bërë ato të aplikueshme sa më parë.

**Menjëherë**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i minutave të takimit të zhvilluar midis Bashkisë Korçë dhe Nismës A më datë 20.05.2021 dhe 21.05.2021, u konstatua se termat e marrëveshjes së bashkëpunimit janë dakordësuar midis palëve, ku bashkia angazhohet për një rishikim final para miratimit të kësaj të fundit në Këshillin Bashkiak. Konstatohet gjithashtu se grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion procedura e dakordësimit të tekstit të marrëveshjes nga palët si edhe miratimi final i këtij teksti, i cili në vijim është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Korçë. Nga një rishikim formal i tekstit të kësaj marrëveshje vërehet se ka një mungesë konsistence në dy elementë të këtij dokumenti: numri i faqeve dhe aneksi bashkëlidhur marrëveshjes. Lidhur me elementin e parë konstatohet se kjo marrëveshje duhet të përmbajë 8 faqe (nisur nga fakti se faqja e parë e saj është emërtuar 1 nga 8), ndërkohë që rezulton se, pas faqes 8 nga 8 vijohet me faqen 8 nga 9 dhe përsëri 8 nga 8 e 8 nga 9 (pra është shtuar një faqe dhe këto dy faqe përsëriten). Marrëveshja mbyllet me firmat e palëve dhe faqja është pa numër, ndërkohë që firmat e palëve gjenden edhe në faqen 7 nga 8. Lidhur me elementin e dytë, konstatohet se - referuar nenit 10, pika vi) të Dispozitës së Funditë ku thuhet se pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe Aneksi 1 Tabela me zërat e buxhetit - faqet në vijim 8 nga 8 dhe 8 nga 9 nuk kanë emërtimin Aneksi 1 sikundër kërkohet nga vet marrëveshja. Konstatimet sa më lart evidentojnë faktin se një dokument i tillë mund të jetë lehtësisht i manipulueshëm.

Sa i takon aplikimit të Bashkisë Korçë për përfitim të fondeve nga fondi social është konstatuar se deklarata e partneritetit paraqitur së bashku me këtë aplikim me nr. 8975, prot., datë 13.11.2020 është nënshkruar nga Bashkia Korçë (në mungesë dhe me porosi znj. B.TH.), ndërsa në vendin e nënshkrimit dhe vulosjes së këtij dokumenti nga ana e Nismës A firma e Drejtorit Ekzekutiv së bashku me vulën janë të skanuara dhe jo origjinale, Deklarata nuk është nënshkruar njëkohësisht nga të dyja palët, në kundërshtim me normat tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e Shqipërisë dhe VKM nr. 4, datë 19.06.2017 për miratimin e rregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu bashkëlidhur aplikimit është vendosur CD i aplikimit i cili është bosh.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 2) faqe (26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresorë zyrtare në shkëmbimet mes njësive.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Me miratimin e projekt propozimit të Bashkisë Korçë dhe financimin e tij nga Fondi Social, Bashkia Korçë me VKB nr. 59, datë 03.06.2021, ka ngritur strukturën e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen (më tej SHMFF), përbërë prej 8 pozicioneve në varësinë e Drejtorisë së Kujdesit Social. Nga auditimi ka rezultuar se për këtë strukturë nuk ka ende përshkrime të qarta pune dhe nuk janë bërë ndryshimet përkatëse në rregullore. Si pasojë e kësaj nuk ka ndarje të detyrave dhe kompetencave ndërmjet SHMFF dhe PMF (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës). Bashkia Korçë zyrtarisht është përgjigjur se rregullorja është në proces rishikimi dhe se po bashkëpunohet me Nismën A për hartimin e përshkrimeve të punës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 2) faqe (26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë të marrë masa të menjëhershme për të reflektuar sa më shpejt termat e referencës së SHMFF në Rregulloren e Brendshme, pasi ato të kenë marrë miratimet përkatëse për këtë qëllim.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me nenin 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit nënshkruar nga palët nuk është përcaktuar personi i kontaktit për të koordinuar me Nismën A, si nga ana e Bashkisë Korçë, ashtu edhe nga ana e Nismës, duke krijuar problematika pikërisht në përgjegjësitë për saktësimin e protokolleve, procesverbaleve, listave dhe çdo dokumenti tjetër që do të prodhohet në kuadër të zbatimit të marrëveshjes. Komunikimet midis Nisma A dhe Bashkisë Korçë nuk janë realizuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet përcjelljes së materialeve të prodhuara nga A për shërbimin mbështetës për fëmijën dhe familjen, por kanë qenë komunikime elektronike jo zyrtare. Nga auditimi është konstatuar se nga ana e Bashkisë Korçë nuk ka pasur verifikim dhe/ose miratim të të gjitha detyrave/dokumenteve të prodhuara nga Nisma në kuadër të zbatimit të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu konstatohet se Nisma A ka vendosur një punonjës vendor me kohë të plotë, i cili nuk është i vendosur pranë IPSH ó së òLulet e Voglaò.  
*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 2) faqe (26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Korçë të marrë masat për zyrtarizimin e komunikimeve me partnerin e projektit, duke përcaktuar personin e kontaktit për bashkinë dhe duke kërkuar nga NISMA përcaktimin zyrtar të personit të kontaktit, si dhe duke proceduar me miratimet dhe diskutimet përkatëse për çdo dokument të prodhuar nga partneri në përfitim të bashkisë.

**Menjëherë**

## B. MASA SHPËRBLIM DËMI

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma A për òTrajnime stafi, mentorime dhe supervizimeò. Nga Bashkia Vlorë është paguar në total vlera 902,000 lekë dhe nga Bashkisë Korçë është paguar vlera 877,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishin kryer nga të dy bashkitë pilot për sa më poshtë:

Referuar urdhrin të Ministrit të MSHSM nr.548 datë 01.10.2020 òPër ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tijò zbatimi i planit të deinstitutionalizimit do të jetë përgjegjësi e Grupit Teknik të Punës (GTP) në me Komitetin Teknik të ngritur pranë MSHMS. GTP është i përbërë nga përfaqësues të MSHMS, përfaqësues në Shërbimit Social Shtetëror, përfaqësues të ASHDMF-së, Ekspertë të jashtëm të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe të tjerë sipas nevojës por nga sa u konstatua përveç Nisma A për ofrimin e këtyre shërbimeve nuk është përfshirë asnjë anëtar tjetër i GTP-s siç edhe duhet të ishte për zhvillimin e modeleve sa më cilësore.

Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A si pjesë e GTP-s janë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë shërbime për zbatimin e planit të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga dy bashkitë pilot. Bashkia Korçë dhe Vlorë nuk duhet të realizonin pagesa për shpenzime trajnimesh, mentorime dhe supervizime kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save the Children do të jetë për mbështetje teknike ndaj këtij plani, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë përfutues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.

Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar sipas emërimit, orëve dhe çmimit për orë pune nga vetë Bashkitë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 1,779,000 lekë për òtrajtime, mentorime dhe supervizime për të dy bashkitë pilot.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 3) faqe (36) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **877,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma A.

**Deri më datë 30.7.2022**

**11.2 Rekomandimi:** Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **902,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma A.

**Deri më datë 30.7.2022**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të Planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga dy bashkitë pilot, Bashkia Vlorë dhe Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma A përdraft dokumentet “Hartimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit. Nga Bashkia Vlorë me urdhër shpenziminr. 1472 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë dhe nga Bashkisë Korçë me urdhër shpenzimit nr. 1570 datë 28.12.2021 është paguar vlera 325,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishin kryer nga të dy bashkitë pilot për sa më poshtë:

Referuar pikës 3.5 të urdhrit të Ministrisë të MSHSM nr.548 datë 01.10.2020 për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe Planit të Veprimit për Zbatimin e tij këto materiale janë përgjegjësi e GTP dhe do të miratohen nga Komiteti Drejtues.

Në nenin 4 të marrëveshjeve të bashkëpunimit Bashkive dhe Nisma A: përcaktohet se këto materiale duhet të miratohen nga Bashkitë respektive të cilat rezultoi se ishin draft dokumente dhe të pa miratuara.

Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A të cilët kanë hartuar: “*Termet e referencës për ngritjen e Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen, Protokollet, manualët e shërbimit përfshirë mekanizmat e llogaridhënies, Udhëzimi i pilotimit të shërbimit të kujdesit në familje*” dhe janë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË, BASHKINË KORÇË

pjesë e GTP-s, duhet të kishte rol mbështetës për këtë plan si të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe jo të paguhen për shërbimet e realizuara në këto bashki pilot.

Nga auditimi i pagesave të realizuara nga bashkitë pilot nga fondi social i miratuar i MSHMS për këtë organizatë, konstatohet se buxheti për shpenzimet e realizuara nga Bashkia Vlorë nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Ky buxhetim shpenzimesh është hartuar nga Nisma A dhe jo nga Bashkitë respektive dhe vlera e këtyre shpenzimeve duhet të ishin detajuar dhe analizuar nga vetë Bashkitë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 650,000 lekë për draft dokumentet e prodhuara për dy bashkitë pilot.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 3) faqe (36) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **325,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për òHartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit ndaj organizatës Nisma A.

**Deri më datë 30.7.2022**

**12.2 Rekomandimi:** Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **325,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për òHartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit ndaj organizatës Nisma A.

**Deri më datë 30.7.2022**

**12.3 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Grupi Teknik i Punës dhe Komiteti Drejtues të merren për rishikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit. Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot, në mënyrë të tillë, që nëse ky plan rezulton i suksesshëm në dy bashkitë pilot të vijojë të ndiqet në nivel kombëtar. Prandaj përfshirja e anëtarëve të GTP në hartimin e këtyre dokumenteve dhe miratimi i dokumenteve nga Komiteti Drejtues është proces shumë i rëndësishëm.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të planit të Deinstitutionalizimit ka rezultuar se nga Bashkia Korçë, janë kryer pagesa kundrejt Nisma A me urdhër shpenzimin nr. 1572 datë 28.12.2021 për shpenzimet: òMenaxhim shërbimiò në vlerën 180,000 lekë, òOficer financeò në vlerën 150,000 dhe òLogjist/shoferò në vlerën 80,000 lekë. Këto pagesa nuk duhet të ishte kryer nga Bashkia Korçë për sa më poshtë:

Ekspertët e jashtëm të OJF Nisma A si pjesë e GTP-s janë të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar dhe nuk ka vend që të kryejnë shërbime për zbatimin e planit të Deinstitutionalizimit kundrejt pagesës nga bashkia pilot. Bashkia Korçë nuk duhet të realizonte pagesa për shpenzime òMenaxhim shërbimiò, òOficer financeò dhe òLogjist/shoferò kundrejt kësaj organizate për aq kohë sa përfshirja e organizatave ndërkombëtare si UNICEF dhe Save





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE, SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, BASHKINË VLORË,**  
**BASHKINË KORÇË**

the Children do të jetë për mbështetje teknike ndaj këtij plani, ndërkohë në këtë rast ekspertët e jashtëm A të kontraktuar nga partnerët ndërkombëtar janë përfitues nga kjo kontratë dhe jo mbështetës për realizimin e Planit.

Në kontratat e punësimit të këtyre punonjësve të hartuara nga nisma A nuk është përfshirë bashkia si palë interesi dhe si përfituese e këtij shërbimi por është mjaftuar vetëm në kontratat e lidhura nga Nisma A me punonjësit. Gjithashtu shërbimi që është ofruar nga oficer financeö dhe oficer Logjist/Shoferö nuk dokumentohet nga Bashkia Korçë.

Nga sa më sipër, Nisma A ka përfituar padrejtësisht pagesën prej 410,000 lekë për shërbime të kryera nga personeli i punësuar prej saj, për një punë të pa dokumentuar dhe pa detyrime juridike për Bashkinë Korçë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (III. 2. 3) faqe (36) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **410,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për ofrim shërbimi, oficer financeö dhe oficer shoferö ndaj organizatës Nisma A.

**Menjëherë**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**